


DHIMITËR DHORA

---

# **Bibliografia e botimeve të autorit**

**Bibliography of the author publications**



2020

DHIMITËR DHORA

---

*Profesor doktor,  
“Mësues i Popullit”, “Mjeshtër i Madh”*

*E-mail: dhdhora@yahoo.com*  
Rr. “Hysej”, Nr. 40, Shkodër – Albania

**Bibliografia e botimeve të autorit**  
**Bibliography of the author publications**

2020

## *Përmbajtja / Content*

VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE BOTUESE E <i>PROF. DR. DHIMITËR DHORA</i> / THE SCIENTIFIC AND PUBLICATION ACTIVITY OF <i>PROF. DR. DHIMITËR DHORA</i>	4
BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË AUTORIT / BIBLIOGRAPHY OF THE AUTHOR PUBLICATIONS	
Botime shkencore në fushën e malakologjisë / Scientific publications in the malacological field	11
Libra / monografi shkencorë / Scientific books / monographies	48
Artikuj shkencorë në fusha të ndryshme të biologjisë / Scientific articles in different fields of the biology	62
Tekste mësimore / Teaching texts	87
Libra dhe broshura të tjera / Others books and brochures	88
Artikuj shkencorë në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë / Scientific articles in the linguistic and literature field	89
Artikuj shkencorë në fushën e didaktikës së biologjisë / Scientific articles in the biological didactic field	90
Artikuj për modernizimin e biologjisë në shkollë / Articles on the modernization of the biology in school	91
Artikuj divulgativë mbi kafshët / Divulgative articles on the animals	92
Të tjera / others	94
Publicistikë mbi arsimin / Publicistics on the education	95
Veprat më të zgjedhura / More selected works	96

## VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE BOTUESE E PROF. DR. DHIMITËR DHORA \*

The scientific and publication activity  
of *prof. dr.* Dhimitër Dhora



Dhimitër Dhora duke referuar në seancën plenare  
të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Nëntor 2013  
(Foto A. Cungeli)

Lindur në Shkodër me 13 Mars 1947, në një familje të vjetër qytetare të Shkodrës. Shkollimin parauniversitar e kreu në vitin 1964, në Shkodër, pranë shkollës 7-vjeçare dhe më vonë të mesme "Jordan Misja". Vazhdoi shkollimin e lartë në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe u diplomua në degën Biologji-Kimi në vitin 1968. U shqua si student i përparuar dhe me pasion të madh për shkencë. Në konferencën shkencore studentore të vitit 1967, organizuar me rastin e 10-vjetorit të UShT, punimi shkencor i tij, u vlerësua me çmim dhe u botua.

Pas përfundimit të shkollës së lartë, për disa vite, punoi si pedagog në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, pastaj si drejtor i shkollës së mesme Koplík, me tej në administratën e pushtetit lokal dhe prej vitit 1987 si Drejtor i Institutit të Lartë Pedagogjik "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, për pak kohë në detyrën e Rektorit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", të sapo krijuar dhe në vazhdim, deri në Tetor të vitit 2015, si profesor në Departamentin e Biologji – Kimisë, kohë kur doli në pension.

I martuar me Eli Dhora (Huta), mësuese e nderuar e lëndëve biologjike në Shkodër, prej vitesh në pension. Kanë dy djem, Dritanin, specialist i mjedisit, me kontribut në fushën e kërkimit shkencor në zoologji - ekologji, i martuar me Lulzimën (doktoreshë e shkencave në biologji molekulare), të dy të aktivizuar prej vitesh si pedagogë të jashtëm në Universitetin e Shkodrës, si dhe Alpinin, më shumë i njohur për punën me peshqit dhe peshkimin. Të gjithë pjestarët e sipërpërmendur të familjes, ashtu edhe dy motrat e tij, pra gjithsej shtatë, janë shkolluar dhe kualifikuar për biologji-kimi.

I kualifikuar si profesor doktor. Specialist i fushës së Zoologji – Ekologjisë. Ka kualifikim të thelluar pasuniversitar në Zoologji invertebrorë, Embriologji, Malakologji.

Ka shfrytëzuar literaturë në disa gjuhë të huaja.

Ka realizuar disa kualifikime, bashkëpunime dhe vizita në shumë shtete të Europës.

Për afër katër dekada ka qenë titullar i lëndës së Zoologjisë Invertebrorë. Është ndër të parët që, në leksionet e tij, protozoarët i trajtoi si grupim artificial i taksa-ve jomonofiletike, bazuar në ultrastrukturë, paleontologji dhe analiza molekulare. Për herë të parë në Shqipëri përdori kladogramat në studimin e filogjenezës. Formuloi me origjinalitet karakteristikat e kafshëve dhe tipeve të kësaj mbretërie. Theksoi dy teoritë kryesore mbi prejardhjen e kafshëve, zhvilloi të plotë teorinë e origjinës së asimetrisë tek gastropodët, vuri bazat e studimit të dukurisë së metamerisë, implementoi në lëndën e zoologjisë klasifikimin modern, konkretizoi lëndën me biodiversitetin lokal.

Ka qenë titullar edhe i disa lëndëve të tjera në nivele të ndryshme të shkollimit akademik, si të biologjisë së përgjithshme, histologjisë, embriologjisë, filogjenezës së kafshëve, didaktikës së kërkimit shkencor, por edhe mjaft lëndëve të tjera, të cilat kanë shërbyer edhe për formimin e tij si biolog. Autor i programeve mësimore të shumë lëndëve biologjike dhe i disa teksteve mësimore të shkollave të larta.

Ka udhëhequr një numër të madh studentësh në realizimin e diplomave të niveleve të ndryshme të shkollimit universitar. Pjestar i shumë jurive dhe komisioneve të mbrojtjes së disertacioneve dhe fitimit të titujve shkencorë në disa universitete të vendit dhe të huaja.

Veprimtaria e gjatë kërkimore - shkencore i përket më shumë malakologjisë, faunistikës, ekologjisë dhe biogeografisë.

Themelues i fushës së studimit të molusqeve në Shqipëri dhe për herë të parë të studimit të molusqeve detare të Shqipërisë. Drejtues i kërkimit në këtë fushë. Autor i tre vëllimeve të botuara (1996, 2002, 2004), i pari në bashkautorësi me Francisco Welter – Schultes, i botuar në anglisht në Gjermani, si dhe i shumë artikujve dhe publikimeve të tjera shkencore, të realizuara për mbi katër dekada. Ka gjetur për herë të parë për Shqipërinë 181 specie molusqesh. Nga 278 specie të tjera, të parashikuara prej tij si të mundshme për Shqipërinë, mbi 100 janë gjetur deri më sot nga autorë të ndryshëm. Kontributi i kohëve të fundit është përqendruar në hartimin e listave të plota të molusqeve të Shqipërisë (dy të fundit 2014 dhe 2016 me nga rreth 800 specie; gjysma e këtij numri është gjetur në Shqipëri prej tij). Gjithashtu është përqendruar në njohjen e specieve endemike të Shqipërisë, specieve aliene europiane të Shqipërisë, specieve të mundshme për Shqipërinë etj. Lidhur më këto, në një artikull të 2019, në bashkautorësi me Dritan Dhora, dukuritë si biodiversiteti i lartë, endemizmi i lartë, invazioni i ultë janë konsideruar si tri karakteristikat kryesore të faunës së molusqeve të ujërave të ëmbël dhe tokës të Shqipërisë.

Listat e molusqeve detarë të Shqipërisë, të hartuara prej tij, janë unike.

Fondi shkencor prej rreth 13 mijë ekzemplarësh, i koleksionuar prej tij, kryesisht në Shqipëri, për katër dekada, ka shërbyer për studime të shumta edhe për mjaft shkencëtarë të huaj.

Shumë studiues të huaj malakologë ndihmuan, bashkëpunuan dhe promovuan studimet e tij malakologjike. Ndër to mund të veçojmë Francisco Welter – Schultes (Gëtingen),

Luitfried v. Salvini – Plawen (Vienë), Helmut Sattmann (Vienë), Karl Edlinger (Vienë), Peter Subai (Ahen), Hartwig Schütt (Dyzeldorf), Hartmut Nordsieck (Vilingen-Shveningen), Edmund Gittenberger (Leiden), Bernard Hausdorf (Hamburg), Adolf Riedel (Varshavë), Henk Mienis (Jeruzalem), Vollrath Wiese (Cismar), Daniele Beduli (Parmë), Vesna Stamol (Zagreb), Peter L. Reischütz (Horn), ky i fundit në bashautorësi, emërtoi për nder të tij, *Virpazaria dhorai* A., N. & P. L. Reischütz 2010, nje specie të re molusku të tokës, të gjetur në Xhaj të Malësisë së Madhe.

Në botimet e tij gjenden mbi 4000 specie kafshësh të Shqipërisë dhe ujërave ndërkufitare. Autor i librave “Regjistër i Specieve të Faunës së Shqipërisë 2010” dhe “Fauna detare e Shqipërisë (Guidë)” (2006). Në vitin 2018 ka botuar artikullin “Listë paraprake e specieve të zakonshme të faunës së Shqipërisë”, ku renditen si të tilla 633 specie.

Është autor i librit “Fjalor Latinisht-Shqip-Anglisht i emrave të kafshëve të Shqipërisë” (2008), bashkautor i “Fjalorit shpjegues të termave zoologjike” (1991, 337 faqe, shumëfishuar nga USh “Luigj Gurakuqi” në disa kopje), si dhe lidhur me to edhe autor ose bashkautor i disa artikuj të botuar në revista shkencore.

Themelues i fushës së studimit të protozoarëve të ujërave të ëmbël në Shqipëri dhe drejtues i kërkimit në këtë fushë. Dy dekadat e fundit, në bashkautorësi, ka publikuar mjaft punime mbi gjetjen për herë të parë për Liqenin e Shkodrës dhe Shqipërinë të mbi 200 specieve të protozoarëve, mbi ekologjinë, si dhe mbi kultivimin e tyre në 10 terrene të ndryshme ushqimore. Një listë përmbledhëse e specieve është përfshirë tek Dhora, Dh., Dhora, D. & Dhora, A. (2016) “Liqeni i Shkodrës”, fq. 75-83.

Ka revizionuar listën e peshqve të ujërave të ëmbël të Shqipërisë, duke pasuruar dhe modifikuar të dhënat ekologjogjeografike mbi to, si dhe ka hartuar listat e specieve për çdo ekosistem liqenor dhe lumor (2009). Ka shumë botime të tij, të viteve të fundit, në fushën e ihtiologjisë, që kanë të bëjnë me speciet endemike dhe aliene (në bashkautorësi me Alpin Dhora), me speciet e kërcënuara, si dhe për Liqenin e Shkodrës, me me situatat e popullatave të peshqve të tregut, me peshqit si hallkë e rëndësishme e rrjetave ushqimore, me peshqit migrues për në det etj.

Në dekadën e fundit ka hedhur idenë për nevojën e ristartimit të studimeve mbi diversitetin e specieve të kafshëve të Shqipërisë, duke revizionuar ato çfarë njohim dhe zhvilluar intensivisht kërkimin e specieve të reja. Në konferenca ndërkombëtare ka publikuar konstatimin e tij se, studimi i biodiversitetit në botë ndodhet shpesh në rreth vicioz, që shprehet në revizionime taksonomike të shumta, me këthime të shpeshta prapa. Konstaton se, në studimet taksonomike, identifikimi i specieve të reja nuk bëhet i unifikuar, i bazuar në konceptin biologjik, por shpesh në koncepte të ndryshme, çka ka sjell konfondimin e specieve të reja me subspeciet e reja.

Prej dekadash merret me studimin e Liqenit të Shkodrës. Autor i tre librave: 2005, 2012 dhe në bashkautorësi me dy djemtë e tij, Dhora, Dh., Dhora, D. & Dhora, A. “Liqeni i Shkodrës” (2016). Gjithashtu është autor ose bashkëautor i disa librave të tjerë, albumeve, broshurave, guidave dhe artikujve shkencorë mbi Liqenin e Shkodrës. Vitet e fundit studimet dhe botimet e tij mbi Liqenin e Shkodrës janë përqendruar në futjen e një koncepti të ri për njohjen e dukurisë së eutrofikimit, bazuar në identitetin, komponentet dhe dinamikat e ekosistemit, si dhe për studimin e stabilitetit, resiliencës, natyralitetit, menaxhimit të integruar të hierarkisë së habitateve të ekosistemit etj. Ka botuar artikullin “Rikonceptimi në tri principe i menaxhimit të Liqenit të Shkodrës dhe objektivat kryesore (2020).

Ka dhënë kontribut për njohjen e situatës ekologjike të Lumit Buna, Lagunës së Patokut dhe mjaft ekosistemeve të tjera, kryesisht lumore, liqenore dhe bregdetare në Shqipëri dhe është bashkautor i publikimeve të shumta.

Autor i librit “Karakteristikat e Kompleksit hidrologjik të lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe të Vogël”, të botuar në 2017.

Autor i librit “Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma” 2019, i cili përmban pesë artikuj.

Në një artikull të këtij libri të titulluar “Vizioni i zhvillimit: Shqipëria – shtet me përparësi ekologjike”, propozohet që kjo përparësi të sanksionohet në një nen kushtetues, si dhe Kompleksi Hidrologjik i lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, së bashku me Pellgun ujëmbledhës të tij, të shpallet “Rezervë Biosferë Ndërkufitare”.

Disa artikuj të librit bëjnë fjalë mbi zhvillimin e qendrueshëm, veçanërisht mbi interesat mjedisore të tij, si jetike për këtë zhvillim.

Në artikullin „Koncept hipotezë mbi induktimin dhe zhvillimin e jetës në Tokë prej faktorëve kozmikë“, të këtij libër, jepet koncepti i një hipotezë të re të autorit, sipas së cilës kompleksi i lëvizjeve rrotulluese të Universit, forcat kozmike, energjia kozmike etj, konsiderohen si faktorë që induktuan lëvizjen biologjike në Tokë dhe që japin atributet e vetërregullimit të gjitha niveleve të së gjallës.

Në një artikull tjetër të këtij libri jepet opinioni i autorit për realizimin e njohjes së specieve të Globit, ku sfida më e madhe konsiderohet numri kolosal i specieve të panjohura. Autori jep mendimin e përdorimit të një koncepti vizionar të gjithëpranuar për identifikimin e specieve, si dhe të futjes në përdorim të gjerë të kategorisë “specie komplekse”.

Në vitin 2019 ka botuar librin “Fletore me aforizmat e mia”, që përfshin 164 aforizma, ku rreth gjysma i përket fushës së biologjisë.

Ka kontribuar për futjen e metodave matematiko-statistikore për zbulimin e shpërndarjes së vlerave për variable të ndryshme, si dhe korrelacioneve, afërsive, shprehjeve algjebrike të dukurive të ndryshme biologjike etj.

Ka publikuar si autor ose bashkautor disa bibliografi, ku si më të rëndësishme janë ajo mbi molusqet e Shqipërisë (1996) dhe ajo mbi Liqenin e Shkodrës (2007).

Bashkëautor i dy librave të metodikës së biologjisë (1984, 1987), si dhe i shumë artikujve shkencorë dhe redaktorialë, që kanë ideuar reformën në lëndët e biologjisë në shkollë, e që kanë shërbyer për fitimin e titullit “docent” në vitin 1990.

Pjesëmarrës si ekspert në shumë projekte të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, kryesisht të fushës së biodiversitetit, endemizmit, ekologjisë dhe menaxhimit.

Në vitin 2011 ka botuar një libër të veçantë me bibliografinë e botimeve të tij për periudhen 1968-2011. Në vitin 2015 është publikuar në faqen e Bibliotekës së Universitetit “A. Xhuvani”, të Elbasanit versioni elektronik i bibliografisë për periudhen 1968-2015. Në Buletinin Shkencor të USh “Luigj Gurakuqi” / Seria e Shkencave të Natyrës të vitit 2017, prof. Ziso Thomollari dhe prof. Sajmir Beqiraj kanë botuar së bashku, në 70 vjetorin e lindjes së tij, artikullin “Bibliografia e botimeve kryesore për një gjysmë shekulli (1967 – 2017) e prof. dr. Dhimitër Dhora”. Një punim më i plotë, në versionin elektronik, me titull “Veprimtaria shkencore dhe botuese e autorit”, për vitet 1967 – 2018, është hedhur në internet në 2018, në faqen e AnimalBase (Gëtingen).

Në publikimet e autorit përfshihen 57 libra, monografi e broshura; 167 artikuj shkencorë, mbi 100 artikuj divulgativ, propogandistikë etj, si dhe dhjetra referate e kumtesa të mbajtura në veprimtari të ndryshme shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bashkëautorët më të spikatur të tij në fushën e botimeve kanë qënë prof. dr. Luifried von Salvini-Plawen (Vienë), dr. Francisco Welter-Schultes (Gëtingen), profesorët e Universitetit të Tiranës Islam Zeko, Kastriot Misja, Lekë Gjikhuri, Lefter Kashta, Sajmir Beqiraj, Vasil Trojani etj, kolegët e punës në departamentin e Biologji-Kimisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dr. Skender Kopliku, profesorët Fatbardh Sokoli, Adem Bekteshi, profesorët e asociuar Violeta Alushi, Marash Rakaj, Rrok

Smajlaj, autori i shumë albumeve Mithat Dibra, si dhe dy bashkëpunorët më të afërt, djemt e tij, Dritan Dhora dhe Alpin Dhora.

Mijëra faqe dhe fakte nga punimet shkencore janë të publikuara në internet, në faqet e institucioneve shkencore të Shqipërisë (veçojmë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” – ISURSh, Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” – Biblioteka etj.) dhe të vendeve të ndryshme të botës. Shumë prej punimeve të tij janë referenca të artikujve të revistave shkencore, të database-ve të mbi 30 shteteve të botës, të shumë librave dhe monografive të rëndësishme.

I njohur ndërkombëtarisht si specialist, konsulent, bashkëpunor. Për shumë vite ka qenë bashkëpunor i PESI-it (Pan-European Species Directories Infrastructure) – Amsterdam (Holandë), pjesë e PESI Fauna Europaea focal points network (një ndër 35 që kishte nga tërë Europa), gjithashtu në vazhdim si pikë fokale e Fauna Europaea online (Museum fur Naturkunde Berlin). Bashkëpunor i AnimalBase – Gëtingen (Gjermani), SeaLifeBase dhe FishBase – Los Banos (Filipine), etj., si dhe në rrjet me to i shumë database-ve të tjera prestigjioze në plan global, rajonal apo lokal, si World Register Marine Species - WoRMS dhe European Register Marine Species - ERMS (Belgjikë), Eu-nomen PESI (Belgjikë), Canadian Register Marine Species - CaRMS (Kanada), Web Museo della Fauna Europea - Ittiofauna (Itali), Wikipedia - Encyclopedia of Life (USA), Catalogue of Life (Holandë), University of Chent UK, Yumpu (Zvicër), Mars Network (Belgjikë), Scribd (San Francisko), Marbef (Holandë), Invasive Species Compendium (UK), IUCN etj.

Prej dekadash ka komunikim dhe ruan të sistemuar në arkivin e tij korespondencën shkencore me shkencëtarë të shquar të institucioneve prestigjioze të mjaft shteteve europiane e më gjerë, veçanërisht të Gjermanisë, Austrisë, Italisë, Holandës, Greqisë, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Hungarisë, Serbisë, Polonisë, Izraelit, Çekisë, Sllovakisë, Bullgarisë, Francës etj.

Eshtë përzgjedhur si antar i komiteteve shkencore të shumë konferencave shkencore ndërkombëtare, të zhvilluara sidomos pas vitit 2000.

Për 18 vite ka qënë kryeredaktor i Buletinit Shkencor. Prej 1987 e deri 1991 ka qenë kryeredaktor i Buletinit Shkencor të Institutit të Lartë Pedagogjik “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, si dhe prej vitit 2001 e deri në 2015 kryeredaktor i Buletinit Shkencor të USh “Luigj Gurakuqi” / Seria e Shkencave të Natyrës.

Për më shumë se dy dekada ka qenë kordinator i ILP dhe USh “Luigj Gurakuqi” në Associated School – UNESCO, i vetmi institucion i arsimit të lartë të Shqipërisë që aderon në këtë organizatë.

Si drejtor i ILP “Luigj Gurakuqi”, ka qenë pjesëmarrës, për herë të parë nga ky institucion, në konferencën e universiteteve mesdhetare (CUM) në Marakesh (Marok), në Maj të vitit 1990.

Eshtë antar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave dhe i grupit themelues të saj në vitin 2011.

Antar i Shoqatës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, si dhe i Shoqatës së Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë.

Mban titujt e lartë të nderit: “Mësues i Popullit” dhe “Mjeshtër i Madh”.

Në komunikimet e mjaft kolegëve të tij të universiteteve dhe institucioneve shkencore të huaja dhe të vendit, në parathëniet e disa disertacioneve, në diskutimet e ish studentëve të tij, shprehen konsiderata të larta për të, si lektor dhe shkencëtar i shquar, si vizionar, me mendim të kthjelltë e të thelluar, si intelektual i spikatur, i kulturuar, i edukuar dhe fisnik, si modeli shëmbullor i profesorit, kërkuesit dhe kolegut.



\* Ky material është marrë prej artikullit të sipërpërmendur të prof. dr. Z. Thomollari & prof. dr. S. Beqiraj (Nëntor 2017), është plotësuar me të dhëna të tjera të marra nga një CV e përgatitur nga Rektorati i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në Dhjetor 2017, si dhe është modifikuar në tërësi nga Dritan Dhora dhe Alpin Dhora, bazuar në dokumenta të ndryshme.

**BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË AUTORIT /  
BIBLIOGRAPHY OF THE AUTHOR PUBLICATIONS**

**BOTIME SHKENCORE NË FUSHËN E MALAKOLOGJISË /  
SCIENTIFIC PUBLICATIONS IN THE MALACOLOGICAL FIELD**

**DHORA, DH. (1975): Rezultate të studimit të molusqeve të Liqenit të Shkodrës. Buletini i Shkencave të Natyrës 1: 65 – 69. Tiranë.**

Në këtë punim përshkruhen nga ana sistematike dhe ekologo-gjeografike 18 specie molusqesh të Liqenit të Shkodrës. 47 % të këtij numri e përbëjnë pulmonatët, të cilët jetojnë kryesisht në pjesën kënetore, 29,5 % janë të nënklasës Prosobranchia dhe 23,5 % të klasës Bivalvia. Duke marrë në konsideratë dëmet dhe rendësinë që i sjellin njeriut, molusqet e ujërave të ëmbël paraqesin një rendësi të madhe studimi.

Results of the study of molluscs of the Shkodra Lake

In this work are described in the systematical and ecologo-geographical view 18 mollusc species of the Shkodra Lake. 47 % of this number are Pulmonata, which live particularly in the swamp part, 29,5 are of Prosobranchia subclassis and 23,5 % of Bivalvia classis. Take in consideration the loss and importance, give to the people, the freshwater molluscs show a great studied importance.

**DHORA, DH. (1976): Të dhëna nga studimi i molusqeve të Shqipërisë së Ulët Bregdetare. Buletini i Shkencave të Natyrës 1: 69 – 72. Tiranë.**

Në këtë punim paraqiten molusqet e ujërave të ëmbla të gjetura në Shqipërinë e Ulët Bregdetare. Nga këta *Physa acuta* DRAPARNAUD, *Radix pereger* MÜLLER (sot *Radix labiata* ROSSMASSLER 1835, shënim i autorit), *Radix lagostis* SCHRANK (sot *Radix labiata* ROSSMASSLER 1835, shënim i autorit), *Radix auricularia* LINNE, *Galba truncatula* MÜLLER dhe *Planorbis planorbis* LINNE, janë molusqet më të zakonshme të të gjithë zonës. Në përgjithësi jepet ambjenti ekologjik, i shoqëruar me shpërndarjen gjeografike dhe frekuencën e llojeve të gjetura. Në mënyrë të veçantë këto të dhëna jepen për 8 specie të reja të papërshkruara më parë për vendin tonë.

Data from the study of molluscs of the Low Coastal Albania

In this work are presented the freshwater mollusks found in the Low Coastal Albania. From these *Physa acuta* DRAPARNAUD, *Radix pereger* MÜLLER (today *Radix labiata* ROSSMASSLER 1835, note of the author), *Radix lagostis* SCHRANK (today *Radix labiata* ROSSMASSLER 1835, note of the author), *Radix auricularia* LINNE, *Galba truncatula* MÜLLER and *Planorbis planorbis* LINNE are more commonly molluscs of all zone.

In general is given the ecological environment, together with geographical distribution and frequency of finding species. Particularly these data are given for 8 species, undiscribed before for our country.

**DHORA, DH. (1978): Mbi disa dyflegërorë më të njohur të zonave të Shëngjinit dhe të Vlorës. Buletini i Shkencave të Natyrës 2: 89 – 93. Tiranë.**

Në këtë punim bëhet fjalë për molusqet dyflegrorë (Bivalvia) të pjesës shqiptare të detit Adriatik. Këtu paraqiten 39 lloje, kryesisht të brigjeve (Shëngjini e Vlorë), që kanë më tepër rëndësi për studim dhe që ndeshen më shpesh nga llojet e tjera të kësaj klase. Për secilin lloj jepen të dhëna të shkurta mbi kushtet ekologjike, frekuencën dhe mënyrën e grumbullimit të tyre.

On some more known bivalvia of Shëngjini and Vlora zones

In this work is reported on the bivalvia molluscs (Bivalvia) of the albanian part of the Adriatic sea. Here are presented 39 species, particularly of coasts (Shëngjini and Vlora), with more scientific importance and that are found more frequently than other species of this class. For every species are given short informations on the ecological conditions, density and collection method of them.

**DHORA, DH. (1978): Gastropodë prozobrankë të rretheve Shkodër dhe Lezhë. Punim për fitimin e gradës shkencore “Kandidat i Shkencave”. 111 faqe. Tiranë.**

Jepen 63 specie të tokës dhe ujërave të ëmbla të Shqipërisë Veriperëndimore. Për çdo specie jepen të dhëna mbi morfologjinë dhe anatominë, mbi përmasat e guaskave të materialit të grumbulluar, vendgjetjet, si dhe të dhëna të tjera kryesisht të karakterit ekologjik. Bëhen vlerësime të karakterit zoogeografik, konstatime mbi ekologjinë, të dhëna që lidhen me rëndësinë e molusqeve, si dhe të dhëna mbi polimorfizmin.

Prosobranch gastropods of Shkodra and Lezha districts

63 terrestrial and freshwater mollusc species of the Northwestern Albania, are given. For every species are given data on morphology and anatomy, on shell dimensions of the collected material, localities and others data, particularly of the ecological character. Evaluation of the zoogeographical character, observation on ecology, data in reference to importance of molluscs, also data on the polymorphism, are given.

**DHORA, DH. (1979): Disa të dhëna mbi moluskun *Galba truncatula* (MULLER 1774) në kushtet e vendit tonë. Buletini i Shkencave të Natyrës 1: 91 – 96. Tiranë.**

Në këtë punim jepen disa të dhëna për kërmillin *Galba truncatula* (MÜLLER 1774) në kushtet e vendit tonë. Përshkruhen tre mjedise ekologjike ku banon ky kërmill. Në bazë të të dhënave të marra nga terreni për tejdukshmërinë dhe rrjedhjen e ujit, si dhe të analizave kimike për përmbajtjen e oksigjenit, kalciumit dhe klorit, paraqitet spektri ekologjik.

Some data on the snail *Galba truncatula* (MÜLLER 1774)  
in the our country conditions

In this work are given some data on the snail *Galba truncatula* (MÜLLER 1774) in the our country condition. Three ecological environments where lives this snail are described. On base of data, taken from terrain, about the transparence and water flow, also chemical analises about the oxygen, calcium and chlorine content, is presented the ecological specter.

**DHORA, DH. (1981): Lloje të reja kërmijsh të rendit Stylommatophora të vendit tonë. Buletini i Shkencave të Natyrës 2: 79 – 81. Tiranë.**

Në këtë artikull paraqiten 17 specie kërmij Stylomatophora, të gjetur në Shqipërinë Veriperëndimore, me të dhënat ekologjike dhe zoogeografike përkatëse.

New snail species of the ordo Stylomatophora of our country

In this article are presented 17 snail species of Stylomatophora, found in North-Western Albania, with the respective ecological and zoogeographical data.

**DHORA, DH. (1983): Mbi kërmillin *Viviparus mamillatus* KÜSTER të vendit tonë. Buletini i Shkencave të Natyrës 1: 101 – 103. Tiranë.**

Në këtë artikull shkruhet për kërmillin *Viviparus mamillatus* KÜSTER të Shqipërisë. Bëhet përshkrimi i guaskave të materialit të grumbulluar. Jepen të dhëna të hollësishme për përmasat, bazuar në matjet e bëra në 50 ekzemplarë. Guaska më e madhe ka përmasa 60,4 mm x 40,3 mm. Gjithashtu jepen të dhëna ekologjike dhe zoogeografike. Liqeni i Shkodrës mund të jetë kufiri më jugor i përhapjes së kësaj specie në gjatësinë tonë gjeografike.

On the snail *Viviparus mamillatus* KÜSTER of our country

In this article is written on the snail *Viviparus mamillatus* KÜSTER of Albania. The shells description of the collected material is made. Data in detail on the dimensions, based in measurements realised in 50 specimens are given. Biggest shell has dimensions 60,4 mm x 40,3 mm. Ecological and zoogeographical data are also given. The Shkodra Lake can to be the southernmost border of the distribution of this species, in our geographical latitude.

**DHORA, DH. (1985): Tre popullime të kërmillit *Cepaea vindobonensis* FER. (në Shkodër). Buletini i Shkencave të Natyrës 2: 105 – 108. Tiranë.**

Në këtë artikull përshkruhen tre popullata të kërmillit *Cepaea vindobonensis* FER. të gjetura në rrethin e Shkodrës. Me interes të veçantë paraqiten 18 format e ndryshme të gjetura në pyllin e Shirqit. Në fund nxirren disa përfundime për rëndësinë teorike të studimit, ekologjinë dhe variacionin e popullatave.

Three populations of the snail *Cepaea vindobonensis* FER. (in Shkodra)

In this article are described three populations of the snail *Cepaea vindobonensis* FER. found in the Shkodra region. With special interest are presented 18 different forms, found in the Shirqi forest. In the end are drawn some conclusions on the theoretic importance of the study, ecology and the variation of populations.

**DHORA, DH. (1988): Të dhëna për dy lloje kërmijsh të nënfamiljes Helicigoninae. Buletini i Shkencave të Natyrës 2: 95 – 97. Tiranë.**

Në këtë artikull jepen të dhëna për dy specie kërmijsh të nënfamiljes Helicigoninae. Për *Faustina (Catania) trizona rumelica* Rosm. [sot *Helicigona inflata* (Kobelt 1876), shënim i autorit].

Shkruhet se gjindet vetëm në pjesën më veriore të vendit tonë dhe jepet mendimi se duhet të ketë përhapje edhe përtej kufinjve tanë.

Në vazhdim për kërmillin *Campylaea (Dinarica) pouzolzi* Desh. f. *bifasciata* Brus. nxirret përfundimi se Mali i Taraboshit duhet të jetë kufiri më jugor i përhapjes së tij.

#### Data on two snails species of the subfamily Helicigoninae

In this article are given data on two snails species of the subfamily Helicigoninae. For *Faustina (Catania) trizona rumelica* Rosm. [today *Helicigona inflata* (Kobelt 1876), note of the author]. It is written that it is found only in northernmost part of our country and is given the idea that its distribution should be also out our border.

In continuation, for the snail *Campylaea (Dinarica) pouzolzi* Desh. f. *bifasciata* Brus is concluded that the Taraboshi Mountain should be the southernmost limit of its distribution.

**DHORA, DH. (1988): Të dhëna më të plota për dy kërmij të vendit tonë. Buletin Shkencor ILP, 2: 131 – 133. Shkodër.**

Jepen disa vendgjetje dhe konsiderata për përhapjen e *Cochlodina laminata* Müller në Shqipëri. Gjithashtu *Lymnaea stagnalis* e Liqenit të Shkodrës përcaktohet si *Lymnaea fragilis*, sinonime e *Lymnaea stagnalis* var. *producta*.

#### More complete data on two snails of our country

Some localities and considerations on the distribution of *Cochlodina laminata* Müller in Albania are given. Also *Lymnaea stagnalis* of the Shkodra Lake is identified as *Lymnaea fragilis*, synonymous of *Lymnaea stagnalis* var. *producta*.

**DHORA, DH. (1990): Kërmij dëmtues të kulturave bujqësore të rrethit të Shkodrës. Buletini i Shkencave të Natyrës 2: 95 – 97. Tiranë.**

Në këtë punim jepen 18 specie kërmijsh kontinentalë, që janë konstatuar si dëmtues të kulturave të ndryshme bujqësore në ekonomitë fushore të rrethit të Shkodrës.

#### Snails noxious to crops in the Shkodra district

In this article are given 18 species of continental snails ascertained as noxious to crops in the country produce of the Shkodra district.

**DHORA, DH. (1994): Mbi popullatën e kërmillit *Theba pisana* (MULLER 1774) të Velipojës. Buletin Shkencor U Sh “Luigj Gurakuqi” 48, Seria e Shkencave Natyrore, fq. 45 – 48. Shkodër.**

Në këtë artikull shkruhet mbi popullatën e *Theba pisana* (MÜLLER, 1774) të Velipojës në qershor 1993. Bëhet përshkrimi i guaskave, jepen përmasat e tyre, të dhëna ekologo-gjeografike e sidomos për polimorfizmin e popullatës.

#### On the population of the snail *Theba pisana* (MÜLLER, 1774) of Velipoja

In this essay is written about the population of *Theba pisana* (MÜLLER, 1774) of Velipoja in June 1993. It is made the description of shells, are given their dimensions, ecologo-geographical data, and especially for the polimorfism of population.

**DHORA, DH. (1995): List of molluscs of Shkodra Lake. Bios. (Macedonia, Greece) 3: 21 – 24. Thesaloniki.**

This article represent the first attempt is made to show a list of molluscs of the Shkodra Lake. Here are listed 32 species, from which 24 are gastropods and 8 bivalves

#### Listë e molusqeve të Liqenit të Shkodrës

Ky artikull përfaqëson përpjekjen e parë të bërë për të paraqitur një listë të molusqeve të Liqenit të Shkodrës. Këtu renditen 32 specie, prej të cilave 24 janë gastropodë dhe 8 bivalvë.

**DHORA, DH. (1995 – 1996): *Viviparus mamillatus* (KÜSTER 1852) në pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës. Buletin Shkencor U Sh “Luigj Gurakuqi” 48 (1), Seria e Shkencave Natyrore, fq. 47 – 52. Shkodër.**

Autorë të ndryshëm kanë faktuar gjetjen e *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) në ujërat e Liqenit të Shkodrës. Artikulli tregon një përpjekje për të plotësuar dijet për këtë molusk. Rezultatet janë dhënë për katër stacione: Lumi Buna, Shiroka, Bregu lindor afër qytetit të Shkodrës, Zogaj, veç e veç për çdo mjedis. Më tej jepen përfundimet.

Në stinët e ngrohta *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) është gjetur brigjeve të buta të Liqenit të Shkodrës dhe pellgjeve pranë tij. Gjatë dimrit, kur niveli i ujit rritet, ata mbesin në thellësi. Më i bollshëm është në mjediset e makrofitëve submergjente, të cilat shërbejnë si substrakt, strehë dhe mjedis i pasur me oksigjen. Këtu janë gjetur të gjitha stadet e zhvillimit.

Guaskat e reja kanë tri shirita të dukshëm të cilët kalojnë përgjatë spirave, ndërsa më vonë ky fenomen varion. Disa individë të rritur kanë shiritë. Në individë të tjerë shiritët mund të jenë të bashkuar. Së fundi, shiritët mund të jenë të pashquar.

Guaskat e ekzemplarëve të rinj kanë lartësi 10 mm – 30 mm. Në fillim ato kanë pamje kubiko – sferike, ndërsa më vonë raporti lartësi – gjerësi zhvillohet në favor të lartësisë. Përmasat e ekzemplarëve të rritur janë: lartësia 30 mm – 54 mm, gjerësia 23 mm – 42 mm. Ekzemplari më i madh që ne posedojmë ka përmasat 60,4 mm: 40,3 mm. Lartësia mesatare e guaskave të meshkujve është 5 mm më e vogël se e atyre të femrave.

*Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) është prozobranku më i madh dhe më i rëndi ndaj gastropodëve të Liqenit të Shkodrës.

Kjo specie nuk është gjetur në ujëra të tjerë të vendit tonë. Këtu shprehet mendimi se Liqeni i Shkodrës përbën zonën specifike më jugore të përhapjes së kësaj specie

#### *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) in the Albanien part of the Shkodra Lake

Different authors have ascertained the founding of *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) in the waters of Shkodra lake. A attempts to complete the knowledge about that mollusk have been done. The results are given according to four stations: Buna River, Shiroka, East coast near Shkodra city, Zogaj, particularly for each environment. Then conclusions are done.

In warm seasons *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) is to be found on soft coasts of Shkodra Lake and basins near them. During winter, when the level of water is increased, they remains in

depth. It is more abundant in the environments of submerged macrophytes, which serve as substrate, shelter and rich oxygenous environment. Here all the developing stages are to be found. Young shells have three visible bands which pass along the whorls, while later on this phenomenon varies. Several adult individuals have bands. The band may be united in another individuals. At last, the bands may be indistinct.

The shells of the young specimens have the heights of 10 mm – 30 mm. At the start they have cubical-spherical shape, while later on the proportions height-width develops in favour of height. The dimensions of the adult specimens are: height 30 mm – 54 mm, width 23 mm – 42 mm. The largest specimen that we possess has the dimensions 60.4 mm: 40.3 mm. The average height of male shells is 5 mm smaller than that of the females.

*Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) is biggest prosobranch and heaviest between gastropods of Shkodra Lake.

This species is not to be found in another waters of our country. Here is expressed the opinion that the Lake of Shkodra constitutes the southernmost specific zone of the distribution of that species.

**DHORA, DH. (1997): Molusqet e tokës dhe ujërave të ëmbël. Libri i Kuq (Bimë, Shoqërime bimore dhe Kafshë të rrezikuara), ShRMMNSh, ShRShGjSh, ShBSh, REC. fq. 121 - 134. Tiranë.**

Prezantohen 41 specie të rrezikuara molusqesh të tokës dhe ujërave të ëmbla të Shqipërisë, të shoqëruara me vendgjetjet dhe statusin.

Terrestrial and freshwater molluscs. In: "The Red Book"

41 endangered species of terrestrial and freshwater molluscs of Albania are presented, together with the finding localities and status.

**DHORA, DH. (1997): Molusqet. KASHTA, L., DHORA, DH. & RAKAJ, M. Lista e bimëve dhe kafshëve të Liqenit të Shkodrës (pjesa shqiptare). Botim i Sektorit Shkencor të Bioekologjisë për Liqenin e Shkodrës, U Sh "Luigj Gurakuqi", fq. 20 - 21. Shkodër.**

Në këtë botim janë renditur 17 specie molusqesh të Liqenit të Shkodrës

Molluscs. In: List of plants and animals of the Shkodra Lake (Albanian part)

In this publication are listed 17 mollusc species of the Shkodra Lake.

**DHORA, DH. (1997 – 2000): Molusqe të tokës dhe ujërave të ëmbla të Shqipërisë. Buletin Shkencor U Sh "Luigj Gurakuqi" 49 (1), Seria e Shkencave Natyrore, fq. 47 – 61. Shkodër.**

Këtu paraqitet lista e 156 specieve ose subspecieve të molusqeve të tokës dhe ujërave të ëmbla të Shqipërisë, të koleksionuara prej pak më shumë se dy dekadash.

Materiali, i depozituar në Laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", përfaqëson fondin unikal të molusqeve në Shqipëri.

Kjo është lista më e pasur e molusqeve të tokës dhe ujërave të ëmbla të Shqipërisë, e publikuar deri tani.



101 taksonet prej koleksionit të autorit publikohen për herë të parë. 14 taksonet e listës janë zbuluar për herë të parë për Shqipërinë, prej të cilëve 6 publikohen këtu për herë të parë.

#### Terrestrial and freshwater molluscs of Albania

156 species or subspecies of terrestrial and freshwater molluscs of Albania, collected for a little more than two decades, are listed.

The material deposited in the Laboratory of Zoology of the University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, represents the unique fund of the molluscs in Albania.

This is the richest list of terrestrial and freshwater molluscs of Albania, published till now.

101 taxa from the author’s collections are published for the first time. 14 taxa of the list are discovered by the author for the first time for Albania, out of which 6 are published here for the first time.

**DHORA, DH. (1999): Koregjime taksonomike dhe specie të kërcënuara të molusqeve të Liqenit të Shkodrës. Bio & Eko. Botim i Sektorit Shkencor të Bioekologjisë për Liqenin e Shkodrës, U Sh “Luigj Gurakuqi”, fq. 14 – 16. Shkodër.**

Në këtë artikull bëhet korigjimi taksonomik i pesë specieve të molusqeve të Liqenit të Shkodrës, të botuara prej autorëve të ndryshëm. Jepet gjithashtu lista e specieve të kërcënuara të molusqeve të Liqenit të Shkodrës.

#### Taxonomical corrections and threatened mollusc species of the Shkodra Lake.

In this article is done the taxonomical correction of five mollusc species of the Shkodra Lake, published by different authors. The list of threatened species of the molluscs of the Shkodra Lake, is also given.

**DHORA, DH. (1999): Molusqet (endemike të Liqenit të Ohrit). Raporti Kombëtar “Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin”, Shtojcat / Anekset, C. Lista e taksoneve endemike, fq. 101. Tiranë.**

Jepet lista e 54 specieve endemike të molusqeve të Liqenit të Ohrit

#### Molluscs (endemic of the Ohrid Lake)

List of 54 endemic molluscs species of the Ohrid Lake, is given.

**DHORA, DH. (2000): Molusqet të tjerë të bregdetit shqiptar. Studime Biologjike. Akademia e Shkencave, Instituti i Kërkimeve Biologjike 4: 85 – 90. Tiranë.**

Lista me 29 specie molusqesh të bregdetit shqiptar, paraqitur në këtë artikull, është shtojcë e listës paraprake të botuar prej DHORA & SALVINI – PLAWÉN (1997).

26 specie të kësaj liste publikohen për herë të parë për bregdetin shqiptar, ndërsa 3 specie të përfshira këtu janë marrë prej një punimi të vitit 1969.

Numri gjithsej i specieve që janë gjetur në bregdetin shqiptar arrin 146.

### Other molluscs of the albanian coast

The list with 29 mollusc species of Albanian coast, presented in this article, is addendum of the preliminary list, published by DHORA & SALVINI – PLAWÉN (1997).

From this list 26 species of the Albanian coast are first published, while 3 species are taken from a work of 1969.

Together with the previously reported species the total number of mollusc species found in the Albanian coastal region gets to 146.

**DHORA, DH. (2000): Molusqet. DHORA, DH. & SOKOLI, F. Liqeni i Shkodrës. Biodiversiteti. ShRMMNSh. fq. 19 – 22. Shkodër.**

Në këtë material gjendet një listë e molusqeve të Liqenit të Shkodrës dhe disa cenoza molusqesh prej mjediseve të ndryshme të Liqenit.

#### Molluscs. In “Shkodra Lake. Biodiversity”

In this material is found a molluscs list of Shkodra Lake and some molluscs cenoses from different environments of Lake.

**DHORA, DH. (2002): Konsiderata për faunën dhe cenzat e molusqeve tokësorë të Shqipërisë. Studime Biologjike. Akad. Shk., Inst. Kërk. Biol. Numër special, 5-6, 2001, Konferenca Kombëtare e Zhvillimit të Shkencave Biologjike, 26-27. 04. 2001, Tiranë, fq. 283-286.**

Dhora, Dh. dhe Welter-Schultes, F. kanë gjetur në Shqipëri 151 specie molusqesh të tokës. 33 specie zbulohen për herë të parë për Shqipërinë, për 10 specie saktësohen vendet, për 5 specie konfirmohet ndodhja dhe zbulohen 6 specie të reja. 38 specie i përkasin familjes Clausiliidae, prej të cilave 27 janë endemike lokale ose ballkanike. Ndër 24 specie *Helicigona*, 10 janë endemike lokale, ndërsa 14 i kalojnë kufijtë e vendit, por kanë përhapje të kufizuar.

Shqipëria është ndër vendet më të pasura në Evropë me malakofaunë tokësore dhe gjithashtu një qendër e rëndësishme e zhvillimit të faunave të këtyre grupeve. Malet gëlqerore janë mjediset më të pasura me molusqe tokësore. *Helix secernenda* është shumë e përhapur dhe okupon habitate të ndryshme.

#### Consideration on the fauna and cenosis of terrestrial molluscs of Albania

151 mollusc species are found in Albania by Dhora, Dh. dhe Welter-Schultes. 33 species are discovered for the first time for Albania, for 10 are precised the localities, for 5 are confirmed occurrence and are discovered 6 new species. 38 species belong to Clausiliidae, of whiches 27 are locally or balcanic endemics. From 24 *Helicigona* species, 10 are locally endemics, while 14 exceed the country borders, but have limited distribution.

Albania is from of richest country in Europe with terrestrial moluscsfauna and a important center of the development of the fauna of these groups. The calcareous mountains are the richest environments with terrestrial molluscs. *Helix secernenda* is very distributed and occupy different habitats.

**DHORA, DH. (2002): Molusqe të tokës endemike të Shqipërisë. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi” 52, Seria e Shkencave Natyrore, fq. 67-79. Shkodër.**

Në këtë artikull paraqiten 55 specie të molusqeve të tokës të Shqipërisë që shfaqin dukuri të endemizmit. Clausiliidae dhe *Helicigona* me numrin më të madh janë gjetur kryesisht në lartësitë e maleve. Dukuritë ekogeografike shpesh lënë shteg për të konsideruar popullatat si relikte. Janë të shënuara emrat dhe kordinatat në hartën UTM 10x10 km të vendgjetjeve unike ose të locus typicus shqiptare të taksoneve të paraqitura. Taksonet e paraqitura konsiderohen prioritare për ruajtje dhe mbrojtje.

#### Endemic terrestrial molluscs of Albania

In this article are represented 55 species of terrestrial molluscs of Albania that show endemic phenomena. Clausiliidae and *Helicigona*, with the greatest number, are found mainly in high mountains. The ecogeographical phenomena allow frequently to consider the populations as relicts. The names and coordinates in the UTM 10x10 km map of the unical finding sites or albanian locus typicus of the represented taxa, are noted. The represented taxa are considered with priority for preservation and protection.

**DHORA, DH. (2002): Studime mbi molusqet e Shqipërisë. “Camaj – Pipaj”. 210 faqe. Shkodër.**

Në këtë libër përfshihen 21 artikuj mbi molusqet e Shqipërisë, të shoqëruara me përmbledhje në anglisht. Paraqiten gjithsejt 146 specie të molusqeve të detit, 112 të tokës (nga 184 që njihen deri tani për Shqipërinë) dhe 147 të ujërave të ëmbla (ku përfshihen molusqet e katër liqeneve ndërkufitare, së bashku me ata të ujërave të pellgjeve ujëmbledhëse të tyre). Për çdo specie jepet informacion ekologjik dhe biogeografik.

Shumica e specieve të molusqeve të detit jepen për herë të parë për Shqipërinë.

Ndër molusqet e detit veçanërisht ka rëndësi zbulimi i vendgjetjes së *Charonia tritonis variegata* (LAMARCK, 1816) në Kepin e Gjuhëzës në Karaborun, që përbën pikën më veriore të përhapjes së kësaj specie.

Në mënyrë më të plotë jepen të dhëna për komunitetin e 20 specieve të molusqeve të bregut shkëmbor të Shëngjinit, sidomos për thellësinë e gjetjes, abundancën, gjallesat e veçanërisht algat shoqëruese.

Gjithashtu për 32 specie molusqesh të Velipojës dhe Shëngjinit jepen fakte për ndërveprime me specie të tjera të komunitetit detar, sidomos Algae, Spongia, Anthozoa, Mollusca, Polychaeta, Crustacea dhe Bryozoa.

Ndër 156 specie kontinentale të listës së koleksionit të autorit, 14 taksone janë zbuluar për herë të parë për Shqipërinë.

Në libër një vend të rëndësishëm zënë speciet endemike. Katër liqenet ndërkufitare kanë së bashku 77 specie endemike, 59 prej të cilave (të gjitha Gastropoda) janë të Liqenit të Ohrit.

Gjithashtu paraqiten 55 specie të molusqeve të tokës që shfaqin dukurinë e endemizmit. Për çdo specie jepen vendgjetjet, locus typicus-et, së bashku me kordinatat në hartën UTM 10x10 km. Veçanërisht interesant shfaqet endemizmi tek familja Clausiliidae dhe *Helicigona*.

Studimi thellohet në disa aspekte të biogeografisë së molusqeve kontinentalë. Në mënyrë të veçantë jepen disa observime biogeografike për molusqet e familjes Clausiliidae të Shqipërisë. 34 speciet autoktone të kësaj familje, që i përkasin 16 gjinive dhe shumica endemike ose me luhajtje regjionale, janë fakte që shprehin diversitet shumë të lartë, radiacion të lashtë dhe ndoshta faktin që Shqipëria mund të jetë një qendër e evolucionit të familjes Clausiliidae.

Gjithashtu jepen të dhëna më të plota mbi përhapjen e 9 specieve. Për 7 prej tyre konkludohet se Shqipëria Jugore është pjesa më veriore e përhapjes së tyre. Për *Helicigona inflata* (KOBELT, 1876) jepet harta e arealit, ndërsa për specien endemike me një vendgjetje, *Helicigona maranajensis* (A. J. WAGNER, 1914), jepen të dhëna për guaskën dhe ekologjinë, lidhur me materialet e koleksionuara nga dy vendgjetje të reja.

Disa studime të këtij libri thellohen në ekologjinë e molusqeve. Veçanërisht kjo del tek katalogu i lokaliteteve të shumta me cenozat e molusqeve të tokës dhe ujërave të ëmbla, të cilat shoqërohen me informacion mbi kushtet mjedisore të habitateve të molusqeve, veçanërisht mbi bimësinë. Në mënyrë më plotë kësaj informacioni jepet për *Viviparus mamillatus* (KÜSTER, 1852) të Liqenit të Shkodrës, si dhe për *Galba truncatula* (MÜLLER, 1774) prej mjediseve të ndryshme të Shqipërisë. Spektri ekologjik i ndërtuar tregon se *Galba truncatula* duron kushte me klor dhe përmbajtje të vogël oksigjeni. Për të dy speciet e mësipërme jepet informacion biometrik.

**DHORA, DH. (2009): Vlerësime ekogeografike për peshqit e ujërave të ëmbël të Shqipërisë. Monografi. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 59, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 160-189.**

Jepet lista e 110 specieve të peshqve të ujërave të ëmbël të Shqipërisë, veçoritë ekogeografike dhe statusi i kërcënimit të tyre. 88 specie janë vetëm të ujërave të ëmbël dhe prej tyre 61 janë specie vendase. 42 specie janë endemike lokale ose endemike të Ballkant Perëndimor. 15 specie endemike të Mesdheut janë të kërcënuara në kategoritë CR, EN, VU. Shqipëria duhet të vlerësohet si regjion i rëndësishëm për diversitetin e specieve të peshqve të ujërave të ëmbël dhe endemizmin e tyre. Këto vlera duhen konsideruar si prioritet i ruajtjes. Jepet një aneks me listat e specieve të peshqve të liqeneve dhe lumenjve kryesorë të Shqipërisë.

Ecogeographical valuations on the Albanian freshwater fishes

List of 110 freshwater fish species of Albania, their ecogeographical characters and threatened status are given. 88 species are of freshwaters only, 61 of which are native. 42 species are locally endemics or West Balkanic endemics. 15 mediterranean endemic species are threatened in the categories CR, EN, VU. Albania should be valued as an important region for the freshwater fishes diversity and their endemism. These values should be considered as a conservation priority. Annex with the fish species lists of main Albanian rivers and lakes is given.

**DHORA, DH. (2011): Mbi diversitetin e specieve të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 61, Seria e Shkencave të Natyrës, 61-75, Shkodër.**

Shqipëria ka një potencial të fuqishëm natyror që mundëson një diversitet të lartë të specieve të faunës. Deri sot njihen 9438 specie, prej të cilëve 8416 të tokës dhe ujërave të ëmbël dhe 1022 detare. Numrin më të madh e kanë Insecta, Mollusca, Arachnida, Pisces dhe Aves. Për speciet e tokës dhe ujërave të ëmbël Shqipëria ka 1/26 e Rruzullit për Aves, 1/24 për Crustacea, 1/50 për Mammalia, si dhe 1/5 deri në mbi 2/5 e specieve të Europës për grupet kryesore të Vertebrata. Për speciet detare Shqipëria ndaj Europës ka më shumë se 1/10 e Mollusca, më shumë se 1/6 e Pisces, 3/5 e Reptilia, më shumë se 1/8 e Mammalia, ndërsa ndaj Rruzullit ka 1/86 e Mollusca, 1/53 e Pisces, 1/23 e Reptilia, 1/17 e Mammalia.

Shqipëria përbën 0.019 % të sipërfaqes kontinentale të Rruzullit tokësor dhe ka 0.7% të numrit të specieve të tij, 0.28% të sipërfaqes së Europës dhe ka 5.6% të numrit të specieve të saj. Ndaj 14 shteteve me karakteristika të përafërta, Shqipëria zë vendin e pestë për raportin numër speciesh për sipërfaqe, por ndër të fundit për numrin total të specieve dhe për raportin e këtij numri ndaj atij të Europës.

Parashikohet që fauna e Shqipërisë të ketë rreth 16.000 specie. Shumicën dërmuese të shtesës besohet ta kenë grupet Insecta, Nematoda, Arachnida, Crustacea, grupet e pastudiuara mirë, dhe pas tyre Mollusca, Annelida të detit, Pisces dhe Aves, që do të zbulohen në zona interesante, si liqenet, burimet dhe rrjedhjet nëntokësore, lagunat, brigjet shkëmbore dhe ujërat e thella të detrave, shpellat, pyjet dhe majat e larta,

Eshtë e nevojshme që specialistët dhe universitetet të intensifikojnë studimet taksonomike dhe faunistike, të vendosin bashkëpunime me institucione të huaja, të bëjnë përpjekje për përgatitjen e specialistëve të rinj. Duhet të përsosën metodat morfologjike të studimit, duke i kombinuar me ato të analizës molekulare, të revizionohen grupe të ndryshme, të korrigjohen gabimet e bëra, të eliminohen sinonimitë dhe homonimitë, të vendosen emrat aktualë dhe klasifikimet moderne.

#### On the species diversity of the Fauna of Albania

Albania possess a powerful natural potential that condition a high diversity of the fauna species. 9438 species of which 8416 of terrestrial and freshwater and 1022 marine, are known till now. Much number belongs to Insecta, Mollusca, Arachnida, Pisces and Aves. Concerning terrestrial and freshwater species Albania has 1/26 of Aves, 1/24 of Crustacea, 1/50 of Mammalia of the Earth Globe, also, for the main vertebrate groups, 1/5 to about 2/5 of European species. As far as is concerned marine species, Albania has more of 1/10 of Mollusca, more of 1/6 of Pisces, 3/5 of Reptilia, more of 1/8 of Mammalia of the Europe number, while has 1/86 of Mollusca, 1/53 of Pisces, 1/23 of Reptilia and 1/17 of Mammalia of the Globe species. Albania constitute 0.019% of the continental area of the Earth Globe and has 0.7% of his species number, 0.28% of the Europe area and has 5.6% of her species number. In comparison with 14 country with similar characters, Albania situated in the five place concerning the proportion of the species number towards area, but among last ones for the total number of species, also for the proportion of this number towards the Europe one.

It is foreseen that the Fauna of Albania to have around 16.000 species. The increase to be believed that will belongs particularly to Insecta, Nematoda, Arachnida, Crustacea, unstudied well groups and after them Mollusca, marine Annelida, Pisces and Aves, that will be discovered in interesting zone, as the lakes, springs and underground flows, lagoons, rocky coasts and deep waters, caves, forests and high peaks. It is necessary that the specialists and universities to intensify the taxonomic and faunistic studies, to establish collaborations with foreign institutions, to attempt for the qualification of new specialists. Also it is necessary to be perfected the morphological methods of the study, combining with the molecular analysis, to be revised different groups, to be corrected the mistakes, to be eliminated the synonyms and homonyms, to be puted the actual names and modern classifications.

**DHORA, DH. (2013): Vicious circle in the biodiversity study. Proceeding of the 2nd International Conference “Research and Education in the Natural Sciences”, November 15-16 Shkodër – Albania, Volume 1: 309-315.**

Here are ascertained and argued with examples numerous and frequent taxonomic revisions, where species to be joined in synonymy or to be devided in other species, subspecies convert in species, or or vice versa, the implementations in systems based only on phenetic etc. Often occur returns back, or recyclings. These occur because the identification and evaluation information is partial, without data on the distribution, polymorphism, population variation, individual development, development of populations in time, bilateral ties between taxa etc.

Therefore, in order to accurate the taxonomic studies, it is necessary to be included in the complex biological studies. This will also allow more accurate assessment of the real number of species, as well as

the phenomenon of endemism.

Reforming of taxonomic studies, so naturally, will promote the reforming of databases, giving "certified"

species, based on classified information.

It is puted the need to get out from the vicious circle in the study of biodiversity, passing to a spiral development, which creates the conditions to realize in practice the saying that behind every study occur the renewal of knowledges and theory.

#### Rreth vicioz në studimin e biodiversitetit

Konstatohen dhe argumentohen me shëmbuj revizionime taksonomike të shumta dhe të shpeshta, ku speciet bashkohen në sinonimi, ose ndahen në të tjera, subspeciet bëhen specie, ose edhe e kundërta, implementime në sistema bazuar vetëm në fenetikë etj. Shpesh ndodhin këthime prapa, ose riciklime.

Këto ndodhin sepse informacioni identifikues dhe vlerësues është i njëanshëm, pa të dhëna mbi përhapjen, polimorfizmin, variacionin e popullatave, zhvillimin individual, zhvillimet e popullatave në kohë, lidhjet e ndërsjellta midis taksave etj.

Prandaj, për të saktësuar studimet taksonomike, shtrohet nevoja e përfshirjes së tyre në studime komplekse biologjike. Kjo do të lejojë edhe vlerësimin më të saktë të numrit real të specieve, ashtu edhe të dukurisë së endemizmit.

Reformimi i studimeve taksonomike, në mënyrë të natyrshme, do të nxisë reformimin e databasave, duke dhënë specie të “çertifikuara”, të bazuar në informacion të klasifikuar.

Shtrohet nevoja e daljes prej rrethit vicioz në studimin e biodiversitetit, për të kaluar në një zhvillim spiralor, i cili krijon kushte për të realizuar në praktikë thëniën që, pas çdo studimi të ndodh ripërtëritja e dijeve dhe teorisë.

**DHORA, DH. (2013): On the stability and resilience of the Lake of Shkodra. Proceeding of the 2nd International Conference “Research and Education in the Natural Sciences”, November 15-16 Shkodër – Albania, Volume 1: 27-34.**

For the first time are addressed both environmental characteristics of Shkodra Lake: stability and resilience.

Lake of Shkodra is identified in one of two alternative stable state, characterizing shallow lakes, it with clean water and high abundance of submergent macrophytes.

Three feedbacks that keep the water quality of the lake at normal parameters are given: the content of nutrients in the water and humic production from wetland; content of nutrients in the water and productivity of riparian forest habitats; food chain structures that transfer phosphorus and biogeochemical mechanisms that inhibit recycling of phosphorus from sediments. Macrophytes are considered a key component of the ecosystem and a key factor of stability. They produce nutrients, serve as a link in the food chains, are more important habitats for animals, are inhibiting factors of nutrients recycling (especially phosphorus) from the sediment into the water, etc. Macrophytes are considered slow variable and as such promote resilience. Macrophytes destruction can lead to loss of resilience. While macrophytes and other key components, such as wetland, riparian forests ripariane, fish etc. are normal, intact, Shkodra Lake exhibits high resilience, face successfully the major perturbations.

Factors influencing the high stability and resilience of the Lake of Shkodra are high fluctuation of the nutrients, food chains with no much links, as well as the large number of species that transfer phosphorus from the littoral to pelagial.

Removing of the functional fishes group and discharging of organic pollutants can lead to loss of ecological resilience and consequently the loss of ecosystem stability.

Development of social and ecological systems to be realized through two attributive objectives: keeping of the lake ecological resilience at high capacity, and increasing of the capacity of actors to influence resilience.

Protected area status will bring more riches of species, greater functional diversity and less introduced species.

#### Mbi stabilitetin dhe resiliencën e Liqenit të Shkodrës

Për herë të parë trajtohen dy karakteristika ekologjike të Liqenit të Shkodrës: stabiliteti dhe resiliencia.

Liqeni i Shkodrës identifikohet në një rëndësi prej dy gjendjeve stabile alternative që karakterizojnë liqenet e cekta, atë me ujë të pastër dhe abundancë të lartë të makrofiteve submergjente.

Jepen tre feedback-et që mbajnë cilësinë e ujit të liqenit në parametra normale: përmbajtja e nutrientëve në ujë dhe prodhimi humik prej wetland-it; përmbajtja e nutrientëve në ujë dhe prodhimitaria e habitateve pyjore të bregut; strukturat e zinxhirit ushqimor që transferojnë fosforin dhe mekanizmat biogjeokimikë që inhibojnë riciklimin e fosforit prej sedimentit.

Makrofitet konsiderohen komponent kyç i ekosistemit dhe faktor kyç i stabilitetit. Ato prodhojnë nutrientët, shërbejnë si hallkë e zinxhirëve ushqimorë, janë habitatet me të rëndësishme për kafshët, janë faktorët inhibues të riciklimit të nutrientëve (veçanërisht fosforit) nga sedimenti në ujë etj. Makrofitet konsiderohen variabël i ngadaltë dhe si i tillë promovojnë resiliencën. Shkatërrimi i makrofiteve mund të çojë në humbjen e resiliencës. Përderisa makrofitet dhe komponentët e tjerë kryesorë, si wetland-i, pyjet ripariane, peshqit etj. janë normalë, të pacënuar, Liqeni i Shkodrës shfaq resiliencë të lartë, përballon suksesshëm shqetësimet e mëdha.

Faktorët që mundësojnë stabilitetin dhe resiliencën e lartë të Liqenit të Shkodrës janë fluktuacioni i lartë i nutrientëve, zinxhirët ushqimorë me jo shumë hallka, si dhe numri i madh i specieve që transferojnë fosforin nga bregu në pelagial.

Heqja e grupit funksional të peshqve dhe shkarkimi i ndotësve organikë mund të sjellin humbjen e resiliencës ekologjike dhe për konsekuencë humbjen e stabilitetit të ekosistemit.

Zhvillimi i sistemeve sociale dhe ekologjike duhet të realizohet nëpërmjet dy objektivave atributore: mbajtjes së resiliencës ekologjike të liqenit në kapacitet të lartë, si dhe rritjes së kapacitetit të aktorëve për të influencuar resiliencë.

Statusi i zonës së mbrojtur do të sjell pasuri më të madhe specimesh, diversitet më të madh funksional dhe më pak specie të introduktuara.

**DHORA, DH. (2015): Vlerësime paraprake mbi natyralitetin e Liqenit të Shkodrës. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 65, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 117 - 123. Shkodër**

Për herë të parë për Liqenin e Shkodrës trajtohet koncepti i natyralitetit. Mbi bazën e analizës së të gjitha kriterëve, Liqeni i Shkodrës diagnostikohet i kategorisë 8, në gradientin me 10 kategori të natyralitetit.

Jepet ideja që sipërfaqet natyrore të mbrojtura të Liqenit të Shkodrës, në Shqipëri dhe Malin e Zi, duhet të menaxhohen në drejtim të natyralitetit, ndërsa sipërfaqet e tjera përreth tyre, ku njeriu është prezent, në drejtim të zhvillimit të qendrueshëm, pra në përputhje me konceptin e menaxhimit si “Rezervë Biosferë Ndërkufitare”, të propozuar prej kohësh për tu shpallur.

Preliminary valuations on the naturalness of the Lake of Shkodra

For the first time for the Lake of Shkodra concept of the naturalness is treated. Based in the analyses of all criterion, Lake of Shkodra is diagnosed of the category 8, in the naturalness gradient with 10 categories.

It is given idea that the natural protected area of the Lake of Shkodra, in Albania and Montenegro, should be managed towards the naturalness, while other area around them, where the human is present, towards the sustainability, therefore in conformity with the concept of the management as “Transboundary Biosphere Reserve”, proposed from times to be promulgated.

**DHORA, DH. (2016): Review of the characteristics of Shkodra Lake with a new vision. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 66, Seria e Shkencave të Natyrës, 97-113, Shkodër.**

This article relates the following characteristics of Shkodra Lake: a lacustrin ecosystem, a favourable geographical situation, a tectonic – karstic origin, a large lake – the largest in the Balkan, a watershed – an inexhaustible water resource, a hydrological stabilizer, a rare cryptodepression, a unique archipelago in Europe, a subtropical Lake, an ecosystem with seasonal developments, an environment of littoral character, water with oxygen - sediment with high redox potential, dominance of calcium ions and hydrogen carbonate, a Lake with oligotrophic waters, a sediment with high content of nutrients, a complex of habitats, a macrophyte abundance, a cyprinid Lake - intriguing fishing, high diversity and large amount of birds, high naturalness, a fauna with endemisms, high resilience and high stability.

The recognition of the characteristics of Shkodra Lake will help to diagnose the Lake ecological situations, and perform a scientific management, which provide stability, naturalness, resilience, and increase of potentials, resources, capacities and a sustainable development.

Rishikim i karakteristikave të Liqenit të Shkodrës me një vizion të ri

Në këtë artikull paraqiten karakteristikat e Liqenit të Shkodrës: ekosistem lakustrin, pozitë gjeografike e favorshme, origjinë tektonike – karstike; liqen i madh, më i madhi në Ballkan; pellgu ujëmbledhës - resurs i pashtershëm uji, stabilizues hidrologjik, kriptodepresion i rrallë, arqipelag unikal në Europë, liqen subtropikal, ekosistem me zhvillime stinore, mjedis i karakterit litoral; uji me oksigjen, sedimenti me potencial redoks të lartë; mbizotërim i ioneve kalcium dhe hidrogjenkarbonat; liqen me ujëra oligotrofike; sediment me përmbajtje të lartë nutrientësh; kompleks habitatesh; abundancë makrofitësh; liqen ciprinid, peshkim intrigues; diversitet dhe kapacitet i lartë shpendësh, natyralitet i lartë, faunë me endemizma, resiliencë e lartë, stabilitet i lartë.

Zhvillimi stinor është ekoritmi i liqenit, që kushtëzon ekzistencën, identitetin, stabilitetin, resiliencën, zhvillimin e qendrueshëm të liqenit.

Njohja e karakteristikave të Liqenit të Shkodrës do të ndihmojë për diagnostikimin e situatave ekologjike të liqenit, si dhe për të realizuar një menaxhim shkencor, që siguron stabilitet, natyralitet, resiliencë, rritje të potencialeve, resurseve, kapaciteteve dhe zhvillim të qëndrueshëm.

**DHORA, DH. (2017): Një përpjekje për të hartuar karakteristikat e Lumit Buna. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 67, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 120-136, Shkodër.**

Jepen karakteristikat e Lumit Buna: lum me thurje dhe dredha, me regjim ujqor permanent, rrjedhje sipërfaqësore dhe nëntokësore, pjesë e një sistemi unikal hidrografik, me një nyje unikale hidraulike Drin-Bunë-Liqen, i treti në Mesdheun Europian për sa i përket shkarkimeve të ujit, lum fushor që merr ujëra nga një territor malor, regjim kompleks ujqor, estuar dhe deltë interesante, karaktere biogjeografike mesdhetare dhe dinarike, biodiversitet habitatesh dhe sipërfaqesh, abundancë makrofitësh dhe asociacione interesante, potenciale të spikatura ihtiologjike, gjendet në një nga tri rrugët e migrimit të shpendëve të Europës, delfinë dhe breshka deti, statusi ekologjik - i varfër etj. Këto karakteristika japin informacion të thelluar e të përpunuar, të vlefshëm për njohjen e këtij lumi, por edhe për menaxhimin shkencor të tij.

An attempt to compile the characteristics of the River Buna

The characteristics of the Buna River are given: braided and meandering river, with permanent water regime, surface and underground water flow, part of a unique hydrographic system, with a unique hydraulic junction Drini-Buna-Lake, third in the European Mediterranean concerning to water discharges, lowland river which takes waters from the mountainous territory, complex water regime, interesting estuary and delta, Mediterranean and Dinaric biogeographical characters, biodiversity of habitats and areas, macrophytes abundance and interesting associations, conspicuous ichthyologically potentials, occurred in one of three migratory ways of European birds, dolphins and sea turtles, ecological status - poor etc. These characteristics provide the depth and elaborated information, valid for recognition of this river, but for its scientific management also.

**DHORA DH. (2018): Listë paraprake e specieve të zakonshme të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 68, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 88 - 102. Shkodër.**

Në këtë artikull paraqiten 633 specie të zakonshme të faunës së Shqipërisë. Speciet, të ndara në ato të ujërave të kripura, të ëmbla dhe të tokës, janë renditur alfabetikisht, ndërsa taksa-t më të larta janë renditur sistematikisht. Të dhënat që janë përdorur për identifikimin e specieve të

zakonshme janë marrë nga botime të ndryshme, si dhe nga shënimet e mbajtura nga ekspeditat në terren për disa dekada. Numrin më të madh të specieve të zakonshme të Shqipërisë e kanë Mollusca me 78 specie, Insecta me 174, Pisces me 83 dhe Aves me 137 specie. Revizionimet taksonomike kanë ndryshuar vlerësimet mbi përhapjen dhe ekologjinë, pra edhe vlerësimet si të zakonshme të mjaft specieve, e sidomos të mjaft molusqeve kontinentalë, krimbave të tokës, araknidëve, insekteve, peshqve të ujërave të ëmbël, gjitarëve të vegjël etj. Besojmë se kjo listë do ti shërbejë studjuesve, menaxherëve të mjedisit, shoqatave ambientaliste, shkollave etj.

#### Preliminary list of common species of the fauna of Albania.

In this article are presented 633 common species of the fauna of Albania. Species, divided into those of salt waters, freshwaters and soils, are listed alphabetically, while the higher taxa are listed systematically. The data used to identify the common species has been obtained from various publications as well as notes from terrain expeditions during several decades. The largest number of common species of the fauna of Albania are of Mollusca with 78 species, Insecta with 174, Pisces 83 and Aves with 137 species. Taxonomic revisions have changed the valuation on the distribution and ecology, as well as the valuation as common of many species, especially of the continental molluscs, earth worms, arachnids, insects, freshwater fishes, small mammals etc. We believe that this list will serve to researchers, environmental managers, environmental associations, schools, etc.

#### **DHORA, DH. (2019): Koncept hipotezë mbi induktimin dhe zhvillimin e jetës në Tokë prej faktorëve kozmikë. Në: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 5-10.**

Lindja e jetës në Tokë, si dhe zhvillimi i saj, në të gjitha aspektet: fiziologjike, biokimike, evolutive, diversitetit, psikologjike e tj., pra të gjitha dukuritë jetësore janë realizuar dhe realizohen me energji kozmike dhe kontrollohen nga forcat kozmike.

Veprimi i të gjitha këtyre forcave shprehet në historinë e krijimit të Tokës dhe gjen pasqyrimin e vet në çdo "grimcë" të Tokës, të gjallë dhe jo të gjallë.

Me energjinë dhe nën kontrollin e forcave kozmike është induktuar jeta tek sistemi i molekulave organike, i krijuar në supën primordiale.

Universi mund të konsiderohet si supernivel hirarkik i gjallë. Çdo gjë është pjesë e së tërës, pjesë e një "makinerie" që punon automatikisht dhe pa pushim. Gjithë bota e gjallë zhvillohet në transmision të lëvizjeve rrotulluese të universit.

#### Hypotheses concept on the induce and development of the life in Earth by cosmic factors

The origin of life on Earth and its development in all aspects: physiological, biochemical, evolutionary, diversity, psychological, etc., so all vital phenomena are realized and implemented with the cosmic energy and are controlled by cosmic forces.

The action of all these forces is shown in the creation story of the Earth and finds its reflection in each "particle" of the Earth, living and non-living.

With the energy and control of cosmic forces is induced the life to the organic molecules system, created in the primordial soup.

The universe can be considered as the living hierarchy superlevel. Everything is a part of the whole, part of a "machine" that works automatically and unceasingly. All the living world is developed in transmission of rotatory movements of the universe.

**DHORA, DH. (2019): Vështrim ekologjik mbi sfidat e zhvillimit. Në: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 10-25.**

Në këtë artikull bëhet një trajtesë e sfidave të zhvillimit, duke i vështuar me një optikë ekologjike.

Faktorët sfidues janë të shumtë: me origjinë kozmike, por edhe globale si tërmetet, vullkanet, cunamët, ndryshimet e rrezikshme klimatike, e veçanërisht ngrohja globale dhe përmytjet e mëdha, si dhe aktiviteti shkatërrues i njeriut.

Pasojat mund të jenë fatale, që në më të shumtën vinë nga mosdija, neglizhencat dhe shkatërrimet paradoksale të natyrës nga dora e njeriut. Anarkia, migrimi, dyndjet dhe luftat do të shumëfishojnë humbjet dhe dëmët, por më pas do të duket „dora“ e evolucionit që do të modifikojë njeriun nga pikëpamja natyrore dhe shoqërore.

Jepet një koncept i ri për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin e popullsisë, ku njerëzimi do të kalojë në një mënyrë tjetër jetese, më në interes të natyrës, çka do të lehtësojë mbijetesën e species njerëzore. Përparësia ekologjike trajtohet si kusht për zhvillimin e qëndrueshëm, zhvillim që kupton një cilësi të re, që arrihet duke realizuar disa shndërrime të rëndësishme në sistem dhe shtyllat kryesore.

Strategjitë, e sidomos ato afat gjata duhet të kenë objektiva dhe aktivitete konkrete, që të sigurojnë njohjen dhe përballimin me sa më pak dhimbje të ndryshimeve natyrore globale dhe lokale.

Veçanërisht përcaktimi i identitetit dhe skemave që sigurojnë stabilitetin e ekosistemeve, si dhe monitorimi dhe menaxhimi e gjithë hirarkisë së habitateve duhet të jenë parimet bazë metodologjike.

#### Ecological view on the development challenges

This paper deals with the development challenges, by looking with an ecological optic.

Challenging factors are many: cosmic, but global also, such as earthquakes, volcanoes, tsunami, dangerous climate changes, and particularly the global warming and flooding, as well as destructive human activity.

Consequences can be fatal, that mostly come from the ignorance, neglect and the paradoxical destructions of nature by the man's hand. Anarchy, migration, invasions and wars will multiply the losses and harms, but then it will be appeared the "hand" of the evolution that will modify the man from the natural and social point of view.

A new concept for the life, survival and population development is given, where the humanity will pass into another living way, more in the interest of nature, which will facilitate the survival of the human species. Ecological priority is treated as a condition for the sustainable development, a development that understands a new quality, that is achieved by the realizing of some important transformations in the system and the main pillars.

Strategies, especially long-term ones, should have concrete objectives and activities to ensure the recognition and withstanding with the least pains of global and local natural changes.

Particularly the identification of the identity and schemes that ensure the stability of ecosystems, as well as the monitoring and management of the entire of the habitat hierarchy, should be the basic methodological principles.

**DHORA, DH. (2019): Vështrim mbi interesat mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm. Në: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 25-37.**

Në këtë artikull shkruhet mbi interesat mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm, si themelore dhe jetike. Ato paraqiten në trajtën e pikësnyimeve të interesit mjedisor natyror të zhvillimit të



qendrueshëm. Shumë prej tyre janë marrë nga Programi i ri global 2030 i OKB për zhvillimin e qendrueshëm. Një pjesë tjetër janë përshtatje të principeve shkencore dhe tiparave të zhvillimit të qendrueshëm. Disa pikësynime të interesit ekonomik dhe social janë trajtuar të integruara me interesat mjedisore. 12 pikësynimet janë formuluar dhe shpjeguar në përshtatje me kushtet dhe problemet në Shqipëri. Realizimi i këtyre pikësynimeve kërkon bashkëpunimin e grupeve të interesit, pajtimin e interesave ekonomike e sociale me interesat mjedisore, zhvillimin e integruar të tyre në trajektoren e dëshirueshme.

#### Overview on the environmental concerns of the sustainable development

Environmental interests of sustainable development, as fundamental and vital, are written in this article. They are presented in the form of goals of the natural environmental interest of the sustainable development. Many of them are taken from the UN's New Global 2030 Program on Sustainable Development. Another part are adaptation of the scientific principles and features of the sustainable development. Some of the goals of economic and social interests are addressed integrated with environmental interests. The 12 goals are formulated and explained in accordance to the conditions and problems in Albania. The realization of these goals requires the collaboration of interest groups, the reconciliation of economic and social interests with the environmental interests, their integrated development on the desirable trajectory.

**DHORA DH. (2019): Shqipëria – shtet me përparësi ekologjike. Në: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 37-48.**

Jepen argumenta mbi domosdoshmërinë e sanksionimit të një neni kushtetues me përmbajtje: “Shqipëria është shtet me përparësi ekologjike në zhvillim”, çka ka do të garantonte më shumë zhvillimin e qendrueshëm të vendit. Përcaktohet si objektiv afatshkurtër objektivi për të arritur standartin europian që zonat e mbrojtura të përbëjnë 20 % të sipërfaqes së vendit, në mënyrë që të ruhen dhe mbrohen vlerat dhe resurset natyrore, veçanërisht të biodiversitetit. Për menaxhimin e tyre të suksesshëm, ato duhet të integrohen në peisazhe më të gjera, çka do të zhvillonte studimin, monitorimin dhe edukimin, si dhe do të promovonte zhvillimin e qendrueshëm. Për të realizuar këtë sugjerohet implementimi i konceptit “Rezervë Biosferë” në menaxhim. Si rruga më efektive për menaxhimin e suksesshëm të Kompleksit Hidrologjik të lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, së bashku me Pellgun ujëmbledhës të tij, propozohet shpallja e tij “Rezervë Biosferë Ndërkufitare”. Shqipëria, që posedon pjesë në të gjitha këto ekosisteme dhe sipërfaqe, duhet të ndërmarrë nismën për të arritur marrëveshjen ndërmjet pesë shteteteve ku shtrihet ky Kompleks.

#### Albania - state with ecological priority

Arguments on the necessity of the sanctioning of a constitutional article with content: "Albania is a state with ecological priority in development", are given, which would more guarantee the sustainable development of the country. A short-term objective is set to reach the European standard that the protected areas to consist 20% of the country surface in order to preserve and protect the natural values and resources, especially biodiversity. For their successful management, they should be integrated into wider landscapes, which would develop the study, monitoring and education, also promote the sustainable development. To realize this, it is suggested to implement the "Biosphere Reserve" concept in management. As the most efficient way for the successful management of the Hydrological Complex of the Drini and Buna rivers, as well as the lakes of Shkodra, Ohrid, Prespa and Small Prespa, together with its watershed, is proposed the promulgation of "Transboundary Biosphere Reserve". Albania, which possess parts of all these

ecosystems and areas, should undertake the initiative to reach an agreement between the five states where this Complex is situated.

**DHORA DH. (2019): Vizion zhvillimi: Shqipëria – shtet me përparësi ekologjike. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 69, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 52-59. Shkodër.**

Shih DHORA DH. (2019): Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 37-48.

**DHORA, DH. (2019): Opinion mbi njohjen e diversitetit të specieve në Rruzullin Tokësor. Një: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia – Shkodër. Fq. 37-48.**

Jepet një opinion mbi numrin e specieve të Rruzullit Tokësor, bazuar në shifrat më të besueshme të publikuara dekadat e fundit. Ekzistojnë vështirësi të mëdha për të realizuar njohjen e tyre, por sfida më e madhe është numri kolosal i specieve të panjohura dhe për t'u njohur kërkohen qindra vite kohë, qindra mijë shkencëtarë, qindra milionë dollarë.

Jepen dy faktorë që ndihmojnë ecurinë e këtij aksioni të paparë: përdorimi i një koncepti vizionar për identifikimin e specieve, si dhe futjen në përdorim të gjerë të “species komplekse“, çka parashikohet në Kodin Ndërkombëtar të Nomenklaturës Zoologjike.

#### Opinion on the recognize of the species diversity in the Earth Globe

An opinion is given on the number of species of the Earth's Globe, based on the most reliable data published in recent decades. There are great difficulties to realize their recognition, but the biggest challenge is the colossal number of unknown species and getting to know are requested hundreds of years time, hundreds of thousands of scientists, hundreds of millions of dollars.

Two factors that help the realization of this unprecedented action are given: the use of a visionary concept for the species identification and the use of "complex species", forecasting in the International Code of the Zoological Nomenclature.

**DHORA, DH. (2020): Rikonceptimi në tri principe i menaxhimit të Liqenit të Shkodrës dhe objektivat kryesore. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 70, Seria e Shkencave të Natyrës.**

Në këtë artikull shprehet nevoja e rikonceptimit në princip të menaxhimit të Liqenit të Shkodrës. Këtu përshihen tri principe që duhen mbajtur parasysh: ruajtja e skemës së stabilitetit të Liqenit, zonimi i sipërfaqeve të Liqenit, menaxhim i integruar i habitateve të Liqenit. Menaxhimi i rikonceptuar mbi këto tri principe do të jetë më shkencor dhe më gjithëpërfshirës. Në fund jepen objektiva kryesore të menaxhimit.

#### Reconceptualization on three principles of the management of the Lake of Shkodra and the important objectives

This article express the need to reconceptualize in principle the management of the Lake of Shkodra. Here are included three principles to keep in mind: preserving the Lake's stability scheme, zoning of the Lake's surfaces, integrated management of the habitats of the Lake. Management reconceptualized on these three principles will be more scientific and more inclusive. In the end the important of management objectives are given.

**DHORA, DH. & HYSA, M. (2000): Peshku *Stizostedion lucioperca* (LINNE, 1758) në Liqenin e Shkodrës. Botim i Sektorit të Bio – Eko të Liqenit të Shkodrës. Ush “Luigj Gurakuqi”, 3: 19 – 20. Shkodër.**

Në këtë artikull përshkruhet një ekzemplar i peshkut *Stizostedion lucioperca* (LINNE, 1758), të gjetur në rezervuarin e Grizhës N. 1, i cili komunikon me Liqenin e Shkodrës.

The fish *Stizostedion lucioperca* (LINNE, 1758) in the Shkodra Lake

In this paper is described a specimen of the fish *Stizostedion lucioperca* (LINNE, 1758), found in the reservoir of Grizha N. 1, which communicate with Shkodra Lake.

**KASHTA, L., DHORA, DH. & SOKOLI, F. (2001): Biological acknowledgement on the Albanian part of Shkodra Lake. The Shkodra/Skadar Lake Project. Conference Report 2001, p. 41 – 46.**

**DHORA, DH. & KRAJA, B. (2003): Pula me mjekër, *Otis tarda* LINNE 1758, në afërsi të Shkodrës. Botim i Sektorit të Bio – Eko të Liqenit të Shkodrës. Ush “Luigj Gurakuqi”, 5: 19-20. Shkodër.**

Në këtë artikull shkruhet mbi gjetjen e pulës me mjekërr, *Otis tarda* LINNE 1758, në Oblikë, afër Shkodrës.

Great Bustard, *Otis tarda* LINNE 1758, near of Shkodra.

In this article are written on the finding of Great Bustard, *Otis tarda* LINNE 1758, in Oblika, near of Shkodra.

**ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2004): Listë paraprake e protozoarëve (Protozoa) të Liqenit të Shkodrës. Buletin Shkencor U Sh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 54, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 99 - 118. Shkodër.**

Këtu paraqitet lista e parë e protozoarëve (Protozoa) të gjetur në pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës. Lista përmban 86 specie, prej të cilëve 7 specie janë Mastigophora, 34 Sarcodina dhe 45 Ciliophora. 69 specie janë gjetur brigjeve të cekta, ndërsa 38 në ujëra më të thella, pra midis bimëve submerse, në përbërje të mikrofaunës dhe në plankton.

Preliminary list of protozoans (Protozoa) of the Shkodra Lake

First list of Protozoa found in Albanian part of the Shkodra Lake are presented here. The list contain 86 species, of whiches 7 are Mastigophora, 34 Sarcodina and 45 Ciliophora. 69 species are found in shallow litorals, while 38 in deeper water, between submerged plants, in composition of the microfauna and plankton.

**DHORA, DH. & KRAJA, B. (2005): Gjinden *Aix galericulata* (LINNAEUS 1758) (për herë të parë në Shqipëri), *Branta ruficollis* (PALLAS 1768) dhe *Otis tarda* LINNAEUS 1758 në**

**afërsi të Shkodrës. Buletin Shkencor U Sh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 55, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 129 - 135. Shkodër.**

Në këtë artikull shkruhet mbi gjetjen e tri specieve shpendësh në afërsi të qytetit të Shkodrës. *Aix galericulata* është gjetur për herë të parë në Shqipëri. *Branta ruficollis* dhe *Otis tarda* janë shpend të rallë për Shqipërinë dhe këtu jepen gjetjet e fundit. Jepen karakteristikat dhe fotografitë e shpendëve të gjetur, si dhe diskutimet përkatëse.

*Aix galericulata* (LINNAEUS 1758) (for the first time for Albania),  
*Branta ruficollis* (PALLAS 1768) and *Otis tarda* LINNAEUS 1758  
are found near Shkodra.

In this article is written on the finding of three species of birds in vicinity of the Shkodra city. *Aix galericulata* is found for the first time in Albania. *Branta ruficollis* and *Otis tarda* are rare birds for Albania and here are given the last findings. The characteristics and photographs of found birds, also the respective discussions, are given.

**JUBERTHIE, CH., DHORA, DH. & BERON, P. (2006): Albanie (Republika e Shqipërisë). Encyclopaedia Biospeologica, Vol. I. Edited by C. Juberthie and V. Decu. Second Edition.**

Artikulli ka një pjesë të përgjithshme, pastaj vazhdon me historinë e eksplorimit të shpellave dhe faunës, karstet dhe shpellat, faunën nëntokësore sipas grupeve të ndryshme dhe një pjesë biogeografi. Në fund ka një list të specieve të gjetura dhe bibliografinë.

Albania

Article has a generalities, after continues with history of cave exploration and fauna, karsts and caves, subterranean fauna according different groups and a part of biogeography. In the end has a list of finding species and bibliography.

**ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2006): Protozoarët e Liqenit të Shkodrës. Specie të reja, vlerësime të përgjithshme. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 56, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 107 - 129. Shkodër.**

Në këtë artikull jepen 106 specie protozoarësh, të gjetur për herë të parë në Liqenin e Shkodrës, në pjesën shqiptare. Për çdo specie janë shënuar vendgjetjet, data dhe karakteret mjedisore. Prej një veshtrimi të përgjithshëm shohim se lista e protozoarëve të gjetur deri tani në Liqenin e Shkodrës përmban 254 specie, që i perkasin 156 gjinive dhe 106 familjeve. Tipi Ciliophora përfaqesohet me 76 familje, 115 gjini dhe 171 specie. Prej numrit të përgjithshëm, 246 specie janë të zakonshme dhe me përhapje të gjerë, ndërsa 8 specie janë gjetur në pak vende, kryesisht të Europës. Ndjehet e nevojshme që studimet taksonomike mbi protozoarët e Liqenit të Shkodrës të vazhdojnë në të ardhmen. Veçanërisht duhen kerkuar protozoarët në thellësitë e ujit dhe sedimenteve, në kriptidepresione e në mikrohabitatet e tyre.

Protozoa of the Shkodra Lake. New species, general valuations

There are 106 species of Protozoa given in this article which were found for the first time in the Albanian part of the Shkodra Lake. Localities, data and environmental characters are marked for each species. From a general overview we see that the list of Protozoa found up to now in the

Shkodra Lake contains 254 species, which belong to 156 genus and to 106 families. Phylum Ciliophora is represented with 76 families, 115 genus and 171 species. Of total number, 246 species are common species with wide distribution, whereas 8 species are found in a few localities, mainly in Europe. It is necessary that taxonomic studies on Protozoa of the Shkodra Lake be continued in the future. Protozoans should be investigated particularly in the depth of water and sediments, in cryptodepressions and their microhabitats.

**ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2007): Vlerësime ekologjike mbi protozoarët e Liqenit të Shkodrës. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 57, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 120-149.**

Gjatë viteve 2003-2004 kemi studiuar protozoarët e Liqenit të Shkodrës në mostrat e ujit të marra prej 11 stacioneve. Jepet tabela e specieve të gjetura sipas muajve në stacione të ndryshme. Më shumë specie janë gjetur në qershor-korrik dhe në mjediset e bregut. Numri i specieve të gjetura në plankton është më i madh në pranverë dhe në vjeshtë. Në qershor-korrik është konstatuar përqindje më e madhe e specieve me konstante minimale. 16 çifte cenozash me koeficient ngjashmërie më të lartë se 0,3 janë të qershor-korrikut, ndërsa çifti i dy cenozave të planktonit ka koeficientin më të lartë të ngjashmërisë në shtator. Dendrograma e qershor-korrikut është shumë komplekse. Nivelet e lidhjeve të degëve çifte ose teke të cenozave në dendrograma, rriten nga muaji mars në qershor-korrik dhe zbresin në nëntor. Konkludohet që protozoarët e Liqenit të Shkodrës pershtaten zhvillimeve ekologjike stinore, ndërsa protozooplanktoni ndjek modelin e zhvillimeve të fitoplanktonit.

#### Ecological valuations on the protozoans of the Shkodra Lake

During 2003-2005 years we have studied the protozoans of the Shkodra Lake, in water samples taken from 11 stations. The table of finding species, according months in different stations, is given. More of species are found in June – July and in the litoral environments. The number of species found in plankton is more in spring and autumn. In June – July is ascertained most percentage of species with maximal constant and smallest percentage of species with minimal constant. 16 cenoses pairs with more than 0,3 of similarity index are of June – July, while the pair of two plankton cenoses has highest index in September. June – July dendrograma is very complex. Connection levels of pair or single cenoses branches in dendrograma are increased from March to June – July and decreased in November. It is concluded that protozoans of the Shkodra Lake are adapted to seasonal ecological developments, while the protozooplankton follows the model of phytoplankton developments.

**DHORA, DH & SMAJLAJ, RR. (2007): Hulumtim mbi troftat *Salmo LINNAEUS*, 1758 të Shqipërisë. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 57, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 167-178.**

Jepen gjetjet e fundit të troftave *Salmo trutta*, *Salmo farioides*, *Salmo dentex*, *Salmo mykiss* në Shqipëri dhe Veriut.

Bëhet rishikimi taksonomik i troftave *Salmo* të Shqipërisë dhe paraqitet lista e 12 specieve me emrat aktualë. Sipas specieve jepen nënspeciet dhe format, si dhe bëhet diskutimi i tyre.

Kompleksi hidrologjik i lumit Drin, së bashku me liqenet dhe degët e tyre, konsiderohet një provincë zoogeografike e troftave, me rëndësi rajonale dhe botërore. Diversiteti i lartë prej 11 speciesh dhe shkalla e lartë e endemizmit prej 8 speciesh, të kësaj province, duhet të pasqyrohet më mirë në dokumentet e IUCN.

Eshtë e nevojshme që të ristartohet studimi i troftave të Shqipërisë me një vizion të ri dhe me metoda bashkëkohore.

#### Investigation on *Salmo* LINNAEUS, 1758 trouts of Albania

Last finding of trouts *Salmo trutta*, *Salmo farioides*, *Salmo dentex*, *Salmo mykiss* in North Albania are given.

Taxonomic revision of albanian *Salmo* trouts are made and the list of 12 species with actual name are represented. Subspecies and morpha are given according to species, as well discussions are made.

Hydrological complex of Drini river, together with lakes and their affluents, is considered a trouts zoogeographical province, with a regional and global importance. High diversity of 11 species and the endemism high step of 8 species of this province, should be reflected better in IUCN documents.

It is necessary to restart the investigation on albanian trouts, with a new vision and contemporary methods.

**BEQIRAJ, S. & DHORA, DH. (2007): Regional importance of the fauna of the cross-border River Buna. Rivers and citizens. Cross-border experiences in environmental protection and sustainable development. Edited by: M. Pinna, V. F. Uricchio, M. Aresta, A. Basset. Universita del Salento. pp. 37-51.**

This paper presents some compiled data on the values of the River Buna, mostly in terms of its fauna. These values are presented here together with the geographical, hydrological and ecological characteristics of the Buna area, emphasizing the regional importance of this area as a migrator corridor and biodiversity reserve. Data on several animal groups (molluscs, amphibians, reptiles, fishes, birds and mammals) are given, focusing on the most significant species of regional importance (migratory, rare, endangered) and their most important habitats.

#### Rëndësia rajonale e faunës së Lumit ndërkufitar të Bunës.

Ky artikull paraqet disa të dhëna të mbledhura mbi vlerat e Lumit Buna, kryesisht në lidhje me faunën e saj. Këto vlera paraqiten këtu së bashku karakteristikat gjeografike, hidrologjike dhe ekologjike të zonës së Bunës, duke theksuar rëndësinë rajonale të kësaj zone si një koridor i migrimit. Jepen të dhëna mbi disa grupe kafshësh (molusqe, amfibë, reptilë, peshq, shpend dhe gjitarë), duke u fokusuar në speciet më të rëndësishme të rëndësise rajonale (migruese, të ralla, të rezikuara) dhe habitatet me të rëndësishme.

**DHORA, DH., SMAJLAJ, RR. & DHORA, A. (2008): Katalogu i peshqve të ujërave të ëmbël të Shqipërisë. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 58, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 100 -131.**

Katalogu i peshqve të ujërave të ëmbël të Shqipërisë përfshin 120 specie, prej të cilave 17 konsiderohen të dyshimta. Katalogu është hartuar nëpërmjet azhurnimit të informacionit ekzistues me literaturën bashkëkohore dhe dijet e autorëve. Janë bërë revizionime taksonomike, korrigjime, rregullime të sinonimive dhe homonimive, emërtime aktuale. Gjithashtu janë bërë disa ndryshime përshtatëse në emërtimet në shqip. Për çdo specie janë shënuar vetëm vendgjetjet e konfirmuara nga burime të ndryshme, ose vendgjetjet e autorëve.

## Catalog of freshwater fishes of Albania

Catalog of freshwater fishes of Albania includes 120 species, of which 17 are considered doubtfully. The catalog is compiled by the adjournment of the existing information with the contemporary literature and authors knowledges. Taxonomic revisions, corrections, regulations of synonyms and homonyms, actual denominations, are given. Some adaptive modifications are made on the albanian names. Only the finding localities confirmed by different sources, or the finding localities of authors, are noted for each species.

**ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2008): Vlerësimi i cilësisë së ujërave të Liqenit të Shkodrës nëpërmjet protozoarëve indikatorë. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 58, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 180-193.**

Për herë të parë për Shqipërinë dhe për Liqenin e Shkodrës realizohet vlerësimi i cilësisë së ujërave nëpërmjet protozoarëve indikatorë. Rënia e indeksit të pastërtisë relative në brigje gjatë verës, besojmë se ka lidhje me zhvillimet stinore të Liqenit, ashtu edhe me shtimin e aktivitetit të njerëzve në brigje. Ujrat e hapura duke përfshirë edhe ato ku ndodhen livadhet e makrofiteve të zhytura, konsiderohen relativisht të pastra. Ujërat e Syrit të Sheganit dalin me indeksin më të lartë të pastërtisë relative.

### Quality valuation of the Shkodra Lake waters by the indicatory protozoans

For the first time for Albania and Shkodra Lake it is realized valuation of water quality by the indicator protozoans. We believe that decrease of the relative purity indice in litoral is in relation with seasonal developments of the Lake, also with increase of the human activity in shores. Open waters, inclusive those with submerged macrophytes meadows, are relativity considered clear. Waters of Syri i Sheganit have the highest indice of relative purity.

**DHORA, DH., MANI (BEQIRI), E., BEKTESHI, A. & ULQINI, D. (2009): *Euglena gracilis* KLEBS 1883 në dy terrene ushqimore interesante. Bul. Shk. USh. "Luigj Gurakuqi", Nr. 59, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 81-89.**

Për herë të parë *Euglena gracilis* është kultivuar suksesshëm në shoqërim me *Astasia clebsii* dhe *Pleuronema coronatum* në kushtet e dhomës, në vjeshtë, në një terren ushqimor të përgatitur me ushqim peshku. Bëhët përshkrimi dhe jepen përmasat.

Në terrenin ushqimor të përgatitur me pleh kali *Euglena gracilis* është zhvilluar më mirë në suksesionet e fundit të procesit autodepurifikues.

Për të dy kulturat jepen suksesionet përgjatë 10 javëve, disa të dhëna fiziko-kimikë të rezultuara nga matjet, densiteti kryesisht për *Euglena gracilis*, si dhe shpjegohen fenomenet e konstatuara.

### *Euglena gracilis* KLEBS 1883 in two interesting nutrient terrains

For the first time *Euglena gracilis* is successfully cultivated in accompaniment with *Astasia clebsii* and *Pleuronema coronatum*, in cameral condition, at outumn, in a nutrient terrain prepared with fishfood. It is made the description and given the dimensions.

In the nutrient terrain prepared with horse muck, *Euglena gracilis* is growed better in the last successions of the autodepurification process.

Successions along 10 weeks, some physico-chemical data resulted by measurements, density particularly of *Euglena gracilis*, for both cultures are given, as well as the observed phenomenons are explained.

**RAKAJ, M., DHORA, DH. & BEKTESHI, A. (2009): Evaluation of the ecological status of the Lake Shkodra. Proceedings International Conference on Lakes and Nutrient Loads. Agricultural University of Tirana, Botimet EMAL, 114-121.**

A preliminary evaluation of ecological status of Lake Shkodra based on last five years monitoring and publications is given. The main criteria used are: typology (climate types), hydromorphological parameters (water quantity, water level and pollution degree as result of human activities), chemical parameters (conductivity, pH, Pt and Nt), Secchi disc, biological parameters (chlorophyll a, diversity and biomass of phytoplankton, aquatic macrophytes and piscivorous fishes as well as piscivorous and zooplankton proportion). A scheme of ecological status of Lake Shkodra with different evaluated variables is given.

#### Vlerësimi i statusit ekologjik të Liqenit të Shkodrës.

Është bërë një vlerësim paraprak i statusit ekologjik të Liqenit të Shkodrës bazuar në monitorimet dhe botimet e pesë viteve të fundit . Kriteret kryesore të përdorura janë: tipologjia (tipet e klimës), parametrat hidromorfologjikë (kuantiteti i ujit, niveli i ujit dhe shkalla e ndotjes si rezultat i aktivitetit të njeriut), parametrat kimikë (konduktiviteti, pH, Pt dhe Nt), disku Seki, parametrat biologjikë (klorofila a, diversiteti dhe biomasa e fitoplanktonit, makrofitet e ujit dhe peshqit piscivorë, si dhe raporti piscivorë me zooplanktonvorë). Jepet një skemë e statusit ekologjik të Liqenit të Shkodrës me variabël vlerësimi të ndryshëm.

**DHORA, DH., DHORA, A. & BEQIRAJ, S. 2009: Preliminary assessment of the age structure of bleak population *Alburnus scoranza* and its fishing impact in Shkodra Lake. (Poster). International Conference: Lakes and Nutrient Loads. Pogradec – Albania, 24 – 26 April 2009.**

**MANI, E. & DHORA, DH. (2010): Suksesionet e kulturave të protozoarëve të Liqenit të Shkodrës në terrene të ndryshme ushqimore. Buletin Shkencor U Sh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 60, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 70-81. Shkodër.**

Për herë të parë në Shqipëri eksperimentohet në vjeshtë, në kushte dhome, përgatitja e kulturave të protozoarëve të Liqenit të Shkodrës në 10 terrene ushqimore të ndryshme. Në artikull renditen speciet sipas kulturave dhe suksesioneve të terreneve të ndryshme ushqimore.

#### Culture successions of Shkodra Lake protozoans in different nutrient terrains

For the first time for Albania the preparing of cultures of Shkodra Lake protozoans in 10 different nutrient terrains in cameral condition, at autumn, is experimented. Species according to cultures and successions of different nutrient terrains, are listed in article.



**MANI, E. & DHORA, DH. (2011): Rezultate nga kultivimi i protozoarëve të Liqenit të Shkodrës. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 61, Seria e Shkencave të Natyrës, 75-83, Shkodër.**

Janë përgatitur kultura të Protozoa të Liqenit të Shkodrës në 10 terrene ushqimore të ndryshme. Gjithsej u gjetën 50 specie, prej të cilëve 41 Ciliophora. Në kulturën me qumësht janë gjetur 18 specie, me pleh kali 16, me bar të thatë 14, me dhé e pleh 13, me grurë 12 dhe në të tjerat më pak. 4 specie, *Astasia klebsi*, *Blefarisma undulans*, *Peranema trichophorum*, *Pleuronema coronatum* janë gjetur për herë të parë për Shqipërinë dhe për Liqenin e Shkodrës. Konstatohet afërsi në zhvillimin e suksesioneve të kulturës me bar dhe asaj me pleh kali; në suksesionet e fundit të kulturave me bar të thatë, pleh kali dhe ushqim peshku; numër më i madh i specieve të cilioforëve grabitqarë në dy suksesionet e para të kulturave me dhé e pleh dhe me oriz; dëndësi më e madhe e *Colpidium* dhe *Colpoda* në tre suksesionet e para të kulturave me maja dhe Knop.

#### Results of the cultivation of the Shkodra Lake Protozoa

Cultures of Protozoa of the Shkodra Lake in 10 different nutrient terrains are prepared. In total are found 50 species, of which 41 Ciliophora. In culture with milk are found 18 species, with horse manure 16, with dry grass 14, with earth and manure 13, with wheat 12 and less in others. 4 species, *Astasia klebsi*, *Blefarisma undulans*, *Peranema trichophorum*, *Pleuronema coronatum* found for the first time for Albania and the Shkodra Lake. It is ascertained similarity in development of cultures with grass and horse manure ones; in the last successions of cultures with dry grass, horse manure and fish food; higher number of predatory ciliophora species in two first successions of cultures with earth and manure and with rise; higher density of *Colpidium* and *Colpoda* in three first successions of cultures with barm and Knop.

**KARINI, S. & DHORA, DH. (2012): Zhvillimi i protozoarëve (Protozoa) gjatë dekompozimit të makrofiteve në breg të Liqenit të Shkodrës. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi” Nr. 62, Seria e Shkencave të Natyrës, 64-70, Shkodër.**

Gjatë dekompozimit të një masë makrofitesh në breg të Liqenit të Shkodrës, pranë Zogajve, të përbërë kryesisht prej *Valisneria spiralis* dhe *Potamogeton natans*, protozoarët zhvillohen në suksesione, ku bie në sy zhvillimi i specieve të përmasave të mëdha të cilioforëve dhe atyre indikatore të saprobisë, që marrin pjesë në shpërbërjen e materialit bimor deri në mineralizim. Prej shtatorit në tetor, ndërkohë që dekompozimi ka avancuar prej afër 70% në rreth 85%, diversiteti e specieve të protozoarëve ka ndryshuar 58%. Ky ndryshim, gjithashtu, ka indikuar rritjen e saprobisë prej klasës 2.8 në 3.2.

#### Development of protozoans (Protozoa) during the macrophytes decomposition in the littoral of the Shkodra Lake

During decomposition of a macrophytes masses in the littoral of the Shkodra Lake, near Zogaj, contain of *Valisneria spiralis* and *Potamogeton natans*, protozoans to be developed in successions, where to attract attention the development of ciliophora species of the large dimensions and those saproby indicator, that participate in decomposition of the vegetable material till mineralization. From September to October, upon this decomposition has advanced from near 70% to around 85%, protozoan species diversity has change 58%. This change has also indicated the increasing of the saproby from classis 2.8 to 3.2.

**RAKAJ, M. & DHORA, DH. (2012): Conspicuous values and incisive environmental problems of the Buna River. Journal of Environmental Protection and Ecology, Vol. 13, Nr. 3: 1366-1375.**

In this paper about 29 classes of habitats, 15 more important surfaces, mixed forest of mouth of the Buna River, 7 wooded islands, forest of Maja e Zeze, 7 plant associations included endemic ones of the *Trapa natans* and *Quercus robur*, 237 bird species, the entrance of *Tursiops truncatus* and *Caretta caretta* till Buna river-head, the presence of *Ursus arctos* in Rana e Hedhun and marine fish stocks as more conspicuous values of the Buna River are presented.

Elimination of directly untreated discharges of the sewage of Shkodra city and Ulqini Commune in the river, the reconstruction of irrigation and drainage system and insurance of the fish migration routes, as well as priorities of scientific management of the hydrological conditions and dynamic of the delta of the Buna River, are identified.

Buna River was declared protected region and also in the European green belt was included, but this status must be reconceived as biosphere reserve.

#### Vlerat e spikatura dhe problemet e mprehta mjedisore të Lumit Buna

Në këtë artikull paraqiten 29 klasa të habitateve, 15 sipërfaqe më të rëndësishme, pyllin e përzier në derdhje të Lumit Buna, 7 ishujt pyjor, pyllin e Majës së Zezë, 7 asociacione bimore, përfshi ato të *Trapa natans* dhe *Quercus robur*, 237 specie shpendësh, hyrjen e *Tursiops truncatus* dhe *Caretta caretta* deri në rrjedhjen e sipërme të Lumit Buna, prezencën e *Ursus arctos* tek Rana e Hedhun stokun e peshqve detarë si vlera më e spikatur e Lumit Buna.

Janë përcaktuar si probleme eliminimi i shkarkimit të ujërave të zeza të Qytetit të Shkodrës dhe Komunës së Ulqinit në lum, rindërtimi i sistemit të kullim-vaditjes dhe sigurimi i rrugëve të migrimit të peshqve, si dhe prioritetet e menaxhimit shkencor të kushteve dhe dinamikës hidrologjike të Deltës së Lumit Buna.

Lumi Buna është shpallur zonë e mbrojtur dhe është përfshirë në brezin e gjelbërt europian, por ky status duhet të rikonceptohet si rezervë biosferë.

**ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2012): Potenciale biologjike të integruara në kompleksin Deti Adriatik - Lumi Buna - Liqeni i Shkodrës. International Conference on Marine and Coastal Ecosystems MarCoastEcos2012: Increasing knowledge for a sustainable conservation and integrated management. 25 – 28 April 2012, Tirana, Albania**

Deti Adriatik, Lumi Buna dhe Liqeni i Shkodrës përbëjnë një kompleks unikal ekosistemesh të integruara.

Vazhdimi drejt Jugut i vijës bregdetare Adriatike të Shqipërisë, ndan Detin Mesdhe në dy pjesë: Perëndimore dhe Lindore. Deti Adriatik shquhet prej disa karakteristikave të veçanta ndaj Detit Mesdhe.

Lumi Buna merr mesatarisht 300 m<sup>3</sup>/sek ujë nga Liqeni i Shkodrës dhe po aq nga Lumi Drini dhe i shkarkon në Detin Adriatik. Buna vlerësohet si lumi me prurjet më të mëdha të ujit në Adriatikon Jugor, i dyti në krejt Adriatikon, pas Lumit Po, si dhe i pesti në krejt Mesdheun. Pra Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna janë kontributorë në stabilitetin e komponentit abiotik dhe krejt ekosistemit detar.

Prurjet organike të ngurta të Lumit Buna janë faktor i rëndësishëm për zhvillimin e një komuniteti të pasur gjallesash në estuarin e Bunës, në grykederdhje e deri në thellësi. Influenca e Lumit Buna ndjehet diagonal në det, deri në brigjet e Italisë.

Nga ana tjetër regjimi i lumit Buna në derdhje varet edhe nga faktorë detarë, veçanërisht baticë-zbatica dhe lartësia e dallgëve.

Jepet lista e 66 specieve të peshqve të zënë në derdhje të Bunës, deri në 40 metra thellësi në det. Tregohet rëndësia e madhe për peshkim të qëndrueshëm e këtij resursi ihtik bentic, ndër më të mëdhenjt në Ballkanin Perëndimor, por veçanërisht e specieve *Mullus barbatus*, *Merluccius merluccius*, *Spicara smaris*, *Citharus linguatula*, *Lepidotrigla cavillone*, *Solea solea*, *Torpedo torpedo*.

Jepen të dhëna mbi 9 specie të peshqve dhe kavallëve të Lumit Buna dhe Liqenit të Shkodrës, që janë migrues për në det. Veçohen blinët (*Acipenser*) dhe shoja (*Platichthys flesus*), të cilët tashmë shihen rallë. Tregohet interes për speciet e peshqve migrues me rëndësi për treg si *Mugil cephalus*, *Liza ramada*, *Dicentrarchus labrax*, *Anguilla anguilla*, *Alosa agone* (migruese).

Gjithashtu jepen edhe specie detare të peshqve të tjerë që hynë në Lumin Buna.

Trajtohen raste interesante të gjetjes së delfinit turishkurtër, *Tursiops truncatus* dhe breshkës së detit, *Caretta caretta*, deri në rrjedhjen e sipërme të Lumit Buna.

#### Biological integrated potentials in the complex Adriatic Sea – Buna River – Shkodra Lake

Adriatic Sea, Buna River and Shkodra Lake make up a unique complex of integrated ecosystems. Adriatic Sea is known by some special characteristics compared to the Mediterranean Sea. Buna River and Shkodra Lake are contributors in the stability and biodiversity of the marine ecosystem. The influence of Buna River is felt diagonally in the sea up to the shores of Italy. On the other side, Buna River regime depends from marine factors.

66 species of fishes, caught in estuary of Buna river up to 40m in depth in the sea, have been listed. This bentic resource of fishes is one of the biggest in the Western Balkan, particularly for *Mullus barbatus*, *Merluccius merluccius*, *Spicara smaris*, *Citharus linguatula*, *Lepidotrigla cavillone*, *Solea solea*, *Torpedo torpedo*.

The details about 9 species of Buna River and Shkodra Lake which migrate to sea have been given. Sturgeons (*Acipenser*) and flounder (*Platichthys flesus*) are already rarely seen. Interest is shown for the migrant commercial such as *Mugil cephalus*, *Liza ramada*, *Dicentrarchus labrax*, *Anguilla anguilla*, *Alosa agone* (migrant).

Marine species of other fish, entering Buna River, are also shown.

Data is given about the finding cases of the bottlenose dolphin (*Tursiops truncatus*) and the sea turtle (*Caretta caretta*) up to the upper flow of Buna River.

**DHORA, DH., BEKTESHI, A. & RAKAJ, M. (2013): A new concept for recognizing of the eutrophication phenomenon in Lake of Shkodra. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 63, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 66 - 84.**

Recognition of the phenomenon and level of eutrophication in Lake of Shkodra is done on a new concept, which is based on the recognition of the identity of the lake, feedbacks and responsible components that are involved in the dynamics of nutrients, as well as threatening factors for the development of this phenomenon.

Lake of Shkodra is characterized shallow, with clear water, dominated by rooted macrophytes. Feedbacks holding in normal parameters the lake water quality are identified: the content of nutrients in the water and humic production in wetland; the content of nutrients in the water and productivity of littoral forest habitats; food chain structures that transfer phosphorus from littoral to pelagial and biogeochemical mechanisms that inhibit the recycling of phosphorus from sediments.

Three main components of the ecosystem concerned with the phenomenon of eutrophication was given: wetland, macrophytes and fishes.

Higher content of nutrients in littoral waters and lake bottoms, as well as the abundance of macrophytes show on a normal development of the lake.

The inverse saprobe-trophy relations, which has a great importance in creating of environmentally sustainable situations, were explained. Reduction of the saproby is associated with the increase of the trophy.

Two factors are considered as the main causes for eutrophication of Lake of Shkodra: climatic, hydrologic and meteorological factors resulting from global warming, as well as the human factors, including the discharge of sewages and other organic materials with phosphorus (detergents); usage without criterion of chemical fertilizers in agriculture, whiches drain through karst formations of the lake watershed; increase of organic solid flows from the watershed.

The formulation and implementation of a long-term regional sustainable development strategy was considered as the most efficient way to eutrophication management, where the primary objectives were the protection of the main functional components, reduction of the input of nutrients and organic solid materials from the lake watershed, development of the organic agriculture and ecotourism.

#### Një koncept i ri për njohjen e fenomenit të eutrofikimit në Liqenin e Shkodrës

Njohja e dukurisë dhe nivelit të eutrofikimit të Liqenit të Shkodrës bëhet me një koncept të ri, që bazohet në njohjen e identitetit të liqenit, feedback-eve dhe komponentëve përgjegjës që implikohen në dinamikat e nutrientëve, si dhe të faktorëve kërcënues për zhvillimin e kësaj dukurie.

Liqeni i Shkodrës karakterizohet i cekët, me ujë të këthjelltë, i dominuar prej makrofiteve me rrënjë.

Identifikohen feedback-et që mbajnë në parametrat normalë cilësinë e ujit të liqenit: përmbajtja e nutrientëve në ujë dhe prodhimi humik në wetland, përmbajtja e nutrientëve në ujë dhe prodhimtaria e habitateve pyjore të bregut, strukturat e zinxhirit ushqimor që transferojnë fosforin dhe mekanizmat biogjeokimike që inhibojnë riciklimin e fosforit prej sedimentit.

Jepen tre komponentët kryesorë të ekosistemit që lidhen me dukurinë e eutrofikimit: wetland-i, makrofitet dhe peshqit.

Treguesit më të lartë të përmbajtjes së nutrientëve në ujërat e brigjeve dhe fundeve të liqeni, si dhe zhvillimi i makrofiteve, janë shprehje të zhvillimit normal të liqenit.

Shpjegohen marrëdhëniet inverse saprobi-trofi, të cilat kanë rëndësi të madhe në krijimin e situatave të qëndrueshme ekologjike. Ulja e nivelit të saprobisë shoqërohet me rritjen e nivelit të trofisë.

Dy faktorë konsiderohen si shkaktarët më kryesorë të eutrofikimit të Liqenit të Shkodrës: a) faktorët klimaterikë, hidrologjikë dhe metereologjike, prej ngrohjes globale dhe b) faktorët njerëzorë, ku përfshihen shkarkimet e ujërave të zeza dhe lëndëve të tjera organike me fosfor (detergjentëve); përdorimi pa kriter i plehërave kimike në bujqësi, që drenojnë nëpër formacionet karstike prej pellgut në liqen; shtimi i prurjeve të ngurta organike prej Pellgut Ujëmbledhës.

Si rruga më efikase në menaxhimin e eutrofikimit konsiderohet formulimi dhe implementimi i një strategjie afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal, ku objektivat primare të ishin mbrojtja komponentëve kryesorë funksionalë, reduktimi i inputit të nutrientëve dhe sedimenteve prej Pellgut Ujëmbledhës, zhvillimi i bujqësisë organike dhe ekoturizmit.

#### **DHORA, DH. & DHORA, A. (2015): Peshqit alienë të Shqipërisë. Buletin Shkencor i USH “Luigj Gurakuqi”, Nr. 65, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 94 - 103.**

Jepet lista me 30 specie aliene të peshqve të ujërave të ëmbël të Shqipërisë, të grupuara sipas familjeve dhe të renditura alfabetikisht. Speciet aliene të akuariumeve nuk janë të përfshira.

Speciet me emërtim shkencor aktual shoqërohen me emërtimin në shqip dhe informacionin mbi vendin e origjinës, kohën dhe qëllimin e introduktimit në Shqipëri, vendndodhjet dhe referencat kryesore. Për 9 prej tyre shkruhet se janë peshq alienë invazivë.

#### Alien fishes of Albania

List with 30 alien species of freshwater fishes of Albania, grouped by families and puted in alphabetical order, are given. Alien aquarium species are not included. Species with actual scientific name are accompanied with the names in Albanian and the information on the origin country, the time and intention introduction in Albania, finding localities and main respective references. For 9 of them is written to be invasive alien fishes.

**BEKTESHI, A. & DHORA, DH. (2015): Ecological vision on the sustainable development (Aspects from Albania). Proceedings book of 3<sup>rd</sup> International Conference “Research and Education in Natural Sciences RENS”, focused on “Harmonisation of Environmental Research and Teaching with Sustainable Policy HERTSPO”. University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Faculty of Natural Sciences and Balkan Environmental Association BENA, Shkodër 6-8 November 2015, p. 25-36.**

The full understanding on sustainable development is given and are treated some aspects from Albania. The definition of biodiversity in accordance with problems is given.

In the context of the formulation of policies and strategies should be clearly defined the environmental conservation priority over other fields of the country development. It is required the reconciliation of the economic development with environmental preservation, placing the economy on the rails of ecology. These are seen associated with the development of the complex and sustainable tourism.

Soil conservation and water resources, improvement of irrigation - drainage system, the main pollution sources, spatial planning, urban and rural development, are treated.

It is recommended the increasing of protected areas and the management under the "Biosphere Reserve" concept.

A new concept on the sustainable development management: Correction of what we have done wrong and create of a living environment, more beautiful, richer and healthy. In the restoration projects should be the collaboration of citizens, government agencies, science and technology, business interests.

The main objective of the ecosystem management strategy should be the development of social and ecological systems, with two attributive objectives: maintaining of the ecological resilience in high capacity and increasing of social adaptability.

The quality of social development is achieved by transformations: market capitalism to dual capitalism, quantitative to qualitative growth, haphazard development to the land use planning, competition to mutualism.

#### Vizioni ekologjik mbi zhvillimin e qëndrueshëm (Aspekte nga Shqipëria)

Jepet kuptimi i plotë mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe trajtohen disa aspekte nga Shqipëria. Jepet definicioni i biodiversitetit në përshtatje me problemet.

Në kuadrin e formulimit të politikave dhe strategjive duhet të përcaktohet qartë përparësia e ruajtjes së mjedisit ndaj fushave të tjera të zhvillimin e vendit. Kërkohet pajtimi i zhvillimit ekonomik me ruajtjen e mjedisit, vendosje të ekonomisë mbi binarët e ekologjisë. Këto shihen të lidhura edhe me zhvillimin e turizmit kompleks dhe të qëndrueshëm.

Trajtohen ruajtja e tokës dhe resurseve ujore, përmirësimi i sistemit të vaditje - kullimit, burimet kryesore të ndotjes, planifikimi hapësinor, zhvillimit urban dhe rural.

Rekomandohet shtimi i zonave të mbrojtura dhe menaxhimi sipas konceptit “Reserve Biosferë”. Shprehet një koncept të ri menaxhues mbi zhvillimin e qendrueshëm: Korrigjimi i asaj që kemi bërë gabim dhe krijimi i një mjedisi të gjallë, më të bukur, më të pasur dhe më të shendetshëm. Në projektet restauruese duhet bashkëpunimi i qytetarëve, agjensive shtetërore, shkencës dhe teknologjisë, interesave të biznesit.

Si objektiv kryesor i strategjisë së menaxhimit të ekosistemeve duhet të jetë zhvillimi i sistemeve sociale dhe ekologjike, me dy objektiva atributore: mbajtja e resiliencës ekologjike në kapacitet të lartë dhe rritja e adaptueshmërisë sociale.

Cilësia e zhvillimit shoqëror realizohet me shndërrimet: kapitalizëm i tregut në atë dual, rritje kuantitative në kualitative, zhvillim spontan në planifikim territori, konkurrencë në reciprocitet.

## TEKSTE MËSIMORE / TEACHING TEXTS

DHORA, DH. (1988): Udhëzues për përcaktimin e kafshëve. Pjesa I. Libër i shumëfishuar. ILP “Luigj Gurakuqi”, 60 fq. Shkodër.

DHORA, DH. (1988): Udhëzues për përcaktimin e kafshëve. Pjesa II. Libër i shumëfishuar. ILP “Luigj Gurakuqi”, 60 fq. Shkodër.

DHORA, DH. (2015): Atlas me 238 fotografive me ngjyra të specieve të kafshëve invertebrore. Version elektronik. Përgatitur për studentët e Degës Biologji – Kimi. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Biologjisë. (Ruhet nga: Autori, Laboratori i Zoologjisë i Universitetit të Shkodrës, si dhe i shpërndarë në rrugë elektronike Universiteteve të vendit që kanë degë Biologji ose Biologji - Kimi) etj.

ZEKO, I., MISJA, K., KOPLIKU, S. & DHORA, DH. (1984): Metodika e Biologjisë. UT, Fak. Shkenc. Nat. 156 fq. Tiranë.

ZEKO, I., MISJA, K., ZENELI, F., KOPLIKU, S. & DHORA, DH. (1987): Metodika e Biologjisë. ShBLSh. 146 fq. Tiranë.

KOPLIKU, S., DHORA, DH. & SOKOLI, F. (1989): Biologjia. ShBLU. 216 fq. Tiranë.

DHORA, DH., KOPLIKU, S. & SOKOLI, F. (1990): Udhëzues për punët praktike të biologjisë. ShBLU. 51 fq. Tiranë.

TROJANI, V. & DHORA, DH. (1990): Bazat e gjeografisë fizike të përgjithëshme (2). ShBLU. Dispensë. 358 fq. Tiranë.

TROJANI, V. & DHORA, DH. (1997): Bazat e gjeografisë fizike të përgjithëshme (2). ShBLU. 318 fq. Tiranë.

DHORA, DH. & SOKOLI, F. (1997): Biologjia. Punë laborator. Univ. Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 136 fq. Shkodër.

DHORA, DH. & SOKOLI, F. (1999): Biologjia. Tekst Universitar. Univ. Shkodrës. CP. 257 fq. Shkodër.

MISJA, K. & DHORA, DH. (1999): Udhëzues i praktikave mësimore në terren (Invertebrorët). ShBLU, 218 fq. Tiranë.

ALUSHI, V. & DHORA, DH. (2006). Udhëzues për përcaktimin e 38 specieve të protozoarëve më të zakonshëm të ujërave të ëmbël. USh “Luigj Gurakuqi”. Material i shumëfishuar (tabela përcaktimi dhe skica).

**LIBRA DHE BROSHURA TË TJERA /  
OTHERS BOOKS AND BROCHURES**

DHORA, DH. (1987): Meditim në faunën tonë. ShBLSh, 125 fq, Tiranë.

DHORA, DH., KASHTA, L. & HOTI, M. (1996): Liqeni i Shkodrës. ShRMMNSh, 45 fq. Shkodër.

DHORA, DH. & BEQIRAJ, S. (1997): Shpendët pranë nesh. ShRMMNSh, 55 fq. Shkodër.

KASHTA, L., DHORA, DH. & RAKAJ, M. (1997): Lista e bimëve dhe kafshëve të Liqenit të Shkodrës. Botim i Sektorit të Bio – Eko të Liqenit të Shkodrës. Ush “Luigj Gurakuqi”, 24 fq. Shkodër.

DHORA, DH., IMERAJ, P. & RAKAJ, M. (1998): Rezervati i Velipojës. ShRMMNSh, 24 fq. Shkodër.

DHORA, DH., RAKAJ, M. & IMERAJ, P. (1998): Përroi i thatë. ShPMGjSh, Fletëpalosje dhe 8 faqe të shkruara. Shkodër.

DHORA, DH. & SOKOLI, F. (2000): Liqeni i Shkodrës. Biodiversiteti. ShRMMNSh, 80 fq. Shkodër.

DHORA, DH. & BEQIRAJ, S. (2001): Laguna e Patokut. ShMGjUSh, 52 fq. Tiranë.

DHORA, DH. & DIBRA, M. (2009): Perreth Liqenit të Shkodres. Guidë. CP, 34 fq. Shkodër.



**ARTIKUJ SHKENCORË NË FUSHËN E GJUHËSISË DHE LETËRSISË /  
SCIENTIFIC ARTICLES IN THE LINGUISTIC AND LITERATURE FIELD**

DHORA, DH. (2003): Rreth prejardhjes dhe kuptimit biologjik të disa termave zoologjike. Buletin Shkencor, USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 53, Seria e Shkencave Shoqërore, fq. 51 – 57, Shkodër.

DHORA, DH. (2005): Emërtime butakësh në shqip. Buletin Shkencor, USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 55, Seria e Shkencave Shoqërore, fq. 67 – 75, Shkodër.

DHORA, DH. (2007): Terma zoologjike që përdorën në shqip. Buletin Shkencor, USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 57, Seria e Shkencave Shoqërore, fq. 137 – 145, Shkodër.

DHORA, DH. (2014): Shqiptimi i shkronjave latine në terminologjinë e biologjisë. Tabelë në 2 faqe. Përshtatur nga Dh. Dhora. Shumëfishuar në 100 kopje. Për studentët e Degës Biologji Kimi. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Biologji – Kimisë.

DHORA, DH. (2019): 54 Aforizma. Në: Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia - Shkodër. Fq. 56-61.

LULI, F., DHORA, DH. & KRAJA, B. (1997 – 1998): Emra shpendësh në të folmen e banorëve të Shkodrës. Buletin Shkencor, USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 48, Seria e Shkencave Shoqërore, fq. 23 – 47, Shkodër.

LULI, F. & DHORA, DH. (2002): Kontribut për njohjen e disa emrave shpendësh, peshqish, zvarranikësh dhe gjitarësh. Buletin Shkencor, USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 52, Seria e Shkencave Shoqërore, fq. 57 – 65, Shkodër.

**ARTIKUJ SHKENCORË NË FUSHËN E DIDAKTIKËS SË BIOLOGJISË /  
SCIENTIFIC ARTICLES IN THE BIOLOGICAL DIDACTIC FIELD**

DHORA, DH. (1989): Për një rikonceptim të biologjisë në shkollë. Revista Pedagogjike, 1: 27 – 32. Tiranë.

DHORA, DH. (1989): Për modernizimin e biologjisë në shkollë në prag të hartimit të dokumentacionit të ri. Revista Pedagogjike, 4: 31 – 36. Tiranë.

DHORA, DH. (1989): Të dhëna më të plota për trajtimin deri në lloj të kafshëve pakurrizore në lëndën e biologjisë. Buletin Shkencor, ILP “Luigj Gurakuqi”, 1: 141 – 146. Shkodër.

DHORA, DH. (1990): Për formimin e dijeve biogeografike nëpërmjet lëndëve biologjike dhe gjeografike. Revista Pedagogjike, 4: 10 – 15. Tiranë.

DHORA, DH. (2002): Studimet malakologjike dhe lënda e biologjisë në shkollë. Buletin Shkencor, Ush “Luigj Gurakuqi”, Seria e Shkencave Didaktike, 52: 61 – 66, Shkodër.

**ARTIKUJ PËR MODERNIZIMIN E BIOLOGJISË NË SHKOLLË /  
ARTICLES ON THE MODERNIZATION OF THE BIOLOGY IN SCHOOL**

DHORA, DH. (1973): Pasurimi dhe shfrytëzimi i kabineteve kërkon kualifikimin e kuadrit. Gazeta “Mësuesi”, 3 janar.

DHORA, DH. (1987): Probleme për modernizimin e lëndës së biologjisë në shkollë. Gazeta “Mësuesi”, 27 tetor.

DHORA, DH. (1987): Kërkohet modernizim i praktikave në lëndën e biologjisë. Gazeta “Mësuesi”, 22 dhjetor.

DHORA, DH. (1987): Metodatat aktive në Biologji. Gazeta “Mësuesi”, 7 qershor.

DHORA, DH. (1988): Modernizimi i kabinetit të biologjisë. Gazeta “Mësuesi”, 13 dhjetor.

DHORA, DH. (1989): Mendime për kriteret e modernizimit të lëndës së biologjisë. Gazeta “Mësuesi”, 17 janar.

DHORA, DH. (1989): Për një formim logjik e të qendrueshëm të dijeve biologjike. Gazeta “Mësuesi”, 23 janar.

DHORA, DH. (1990): Biologjia të studiohet e lidhur me interesat tona. Gazeta “Mësuesi”, 22 maj.

**ARTIKUJ DIVULGATIVË MBI KAFSHËT /  
DIVULGATIVE ARTICLES ON THE ANIMALS**

- DHORA, DH. (1975): Letër sekrete. “A” e fundit (lojra). Revista “Pionieri”, 8 maj, fq. 35.
- DHORA, DH. (1975): Kafshët parandjejnë kohën. Revista “Pionieri”, nr. 11.
- DHORA, DH. (1976): Molusqet – bota shtazore më e larmishme. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 6: 28 – 31.
- DHORA, DH. (1977): Fauna e bregdetit tonë e shumëllojtë dhe interesante. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 3: 29 – 33.
- DHORA, DH. (1977): Peshqit endemikë dhe migrues të vendit tonë. Revista “Pionieri”, 6 mars, fq. 30 – 31.
- DHORA, DH. (1981): Mikrofauna e ujërave. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 5: 59.
- DHORA, DH. (1981): Dobia e krimbave të tokës. Revista “Ylli”, 8: 33.
- DHORA, DH. (1981): Mbi faunën e Liqenit të Pogradecit. Revista “Ylli”, 11: 29.
- DHORA, DH. (1982): Dobitë dhe dëmët e molusqeve. Revista “Ylli”, 3: 33.
- DHORA, DH. (1982): Banorët e detrave tanë. Revista “Ylli”, 7: 32.
- DHORA, DH. (1982): Ç’është bionika. Revista “Ylli”, 11: 30.
- DHORA, DH. (1982): “Muzeu” i fosileve të gjalla. Revista “Horizonti”, 9: 9.
- DHORA, DH. (1983): Kafshët e nëntokës. Revista “Ylli”, 3: 32.
- DHORA, DH. (1984): Fauna e jonë. Revista “Ylli”, 3: 32.
- DHORA, DH. (1985): Ekologjia. Revista “Ylli”, 2: 28.
- DHORA, DH. (1985): Koralet. Revista “Ylli”, 9: 29.
- DHORA, DH. (1987): Fauna e jonë dhe studimet për zhvillimin e saj. Revista “Kultura Masive”, 1: 91 – 97.
- DHORA, DH. (1987): Sfungjerët. Revista “Ylli”, 8: 34.
- DHORA, DH. (1988): Peshqit dekorativë të akuariumeve. Revista “Ylli”, 5.
- DHORA, DH. (1988): Probleme të ekologjisë së aplikuar në bujqësi. Gazeta “Jeta e Re”, 29 qershor, fq. 3 – 4.

- DHORA, DH. (1988): Disa probleme rreth ekologjisë së faunës tonë. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 6.
- DHORA, DH. (1989): Kujdesi për mjedisin natyror u përket të gjithëve. Gazeta “Jeta e Re”, 22 shkurt.
- DHORA, DH. (1989): Fauna dhe vlerat e saj ekonomike. Gazeta “Jeta e Re”, 3 qershor, fq. 3 – 4.
- DHORA, DH. (1989): Butakët kryekëmbë. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 4.
- DHORA, DH. (1989): Kërmijtë - pasuri me vlerë për shtimin e eksporti. Gazeta “Jeta e Re”, 6 dhjetor.
- DHORA, DH. (1990): Mbrojtja e mjedisit detyrë e të gjithëve. Gazeta “Jeta e Re”, 9 qershor.
- DHORA, DH. (1991): Polipët dhe meduzat. Revista “Shkenca dhe Jeta”, 1.
- DHORA, DH. (1997): Veçoritë e Liqenit të Shkodrës. Buletin Informativ. Ekoqendra e Liqenit të Shkodrës, 1 korrik, fq. 2.
- DHORA, DH., RAKAJ, M. & IMERAJ, P. (1999): Prej ku rreh krapit tek mrizon cjapi. REC Buletin, Shqipëri (shtator- tetor), fq. 6 – 7.
- DHORA, DH. & BEQIRAJ, S. (1999): Dobia e shpendëve. Revista “Ne dhe Mjedisi”, 17: 10. Tiranë.

### **TË TJERA / OTHERS**

DHORA, DH. (1994): Parathënie. Në: Lekë Gjikhuri. Zoologjia e parruazorëve. ShBLU, fq. 3. Tiranë.

DHORA, DH. (1998): Parathënie. Në: Kastriot Misja. Libri i kuq, për shkollarët. fq. 3. Tiranë.

**PUBLICISTIKË MBI ARSIMIN /  
PUBLICISTICS ON THE EDUCATION**

DHORA, DH. (1986): Shkolla t'u japë nxënësve e studentëve formim të shëndoshë teorik dhe shprehitë e punës aplikative. "Jeta e Re", 24 dhjetor.

DHORA, DH. (1987): Cilësinë e ndihmon opiniononi i shëndoshë. "Bashkimi", 4 shkurt.

DHORA, DH. (1988): Në qendër të vemendjes lufta kundër të mësuarit mekanik e pasiv. Intervistë. "Mësuesi", 20 shtator.

DHORA, DH. (1989): Arritje e kërkime të reja për të mësuarit aktiv e krijues. "Mësuesi", 23 maj, fq. 2.

DHORA, DH. (1989): Si të nxisim më tej punën shkencore te pedagogët. "Zëri i Popullit", 22 nëntor, fq. 1.

DHORA, DH. (1989): Përgatitja e brezit të ri, detyrë fisnike. "Jeta e Re", 25 nëntor.

DHORA, DH. (1989): Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës i jepet emri i Luigj Gurakuqit, "Hero i Popullit", "Mësues i Popullit". Buletin Shkencor i ILP Shkodër, nr. 1.

DHORA, DH. (1991): Pse nuk shitet e blihet ky "prodhim". Mendime për punën shkencore. "Mësuesi", 16 shkurt.

DHORA, DH. (1991): Lidhjet me botën e jashtme dhe zhvillimi bashkëkohor i shkollës. Intervistë. "Bashkimi", 28 shkurt.

DHORA, DH. (1991): Praktika të vjetra si mot dhe sot. Drejt cilësisë së lartë në shkollat e larta. "Mësuesi", 6 prill.

DHORA, DH. (1991): Mundësi për një universitet në Shkodër. "Bashkimi", 29 prill.

DHORA, DH. (1991): Çfarë do ti sjellë Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Shkodrës dhe Shqipërisë. Intervistë. "Bashkimi", 13 korrik.

DHORA, DH. (1991): Apel për mësuesit e mi të nderuar. "Mësuesi", 28 shtator.

**VEPRAT MË TË ZGJEDHURA /  
MORE SELECTED WORKS**

DHORA, DH. & WELTER-SCHULTES, F. (1996): The non-marine molluscs of Albania. Three monographs. Schriften zur Malakozoologie aus dem Haus der Natur – Cismar, Heft 9: 32-224.

DHORA, DH. (2002): Studime mbi molusqet e Shqipërisë / Studies on the molluscs of Albania. Camaj – Pipa, 210 fq.

DHORA, DH. (2004): Mbi molusqet e Shqipërisë / On the molluscs of Albania. Camaj – Pipa, 196 fq.

DHORA, DH. (2008): Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë. Camaj-Pipa. 288 fq. Shkodër.

DHORA, DH. (2009): Vlerësime ekogjeografike për peshqit e ujërave të ëmbël të Shqipërisë. Monografi. Bul. Shk. USh. “Luigj Gurakuqi”, Nr. 59, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 160-189.

DHORA, DH. (2010): Regjistër i specieve të faunës së Shqipërisë 2010. CP. 208 fq. Shkodër.

DHORA, DH. (2011): Mbi diversitetin e specieve të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor Ush “Luigj Gurakuqi”, Nr. 61, Seria e Shkencave të Natyrës, 61-75, Shkodër.

DHORA, DH. (2014): Molluscs of Albania 2014: List of species and biogeographical data. Monografi. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 64 / Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 149 - 181.

DHORA, DH., DHORA, D. & DHORA, A. (2016): Liqeni i Shkodrës. Shtëpia botuese “Fiorentia”, 208 fq.

DHORA, DH. (2017): Karakteristikat e Kompleksit Hidrologjik të lumenjve Drini dhe Buna, si dhe liqeneve të Shkodrës, Ohrit, Prespës së Madhe dhe të Vogël. Florentia, 64 fq. Shkodër.

DHORA, DH. (2018): Listë paraprake e specieve të zakonshme të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 68, Seria e Shkencave të Natyrës. Shkodër.

DHORA, DH. (2019): Vizion. Hipoteza, opinione, aforizma. Fiorentia - Shkodër. 62 fq.

DHORA, DH. (2019): Fletore me aforizmat e mia. Fiorentia, 38 fq. Shkodër.

DHORA, D. & DHORA, DH. (2019): Tri karakteristika kryesore të moluskfaunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor i USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 69 / Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 42-51.

DHORA, DH. (2020): Rikonceptimi në tri principe i menaxhimit të Liqenit të Shkodrës dhe objektivat kryesore. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 70, Seria e Shkencave të Natyrës.